REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# STANDARDET E ZHVILLIMIT DHE TË TË NXËNIT TË FËMIJËVE 3-6 VJEÇ

**Korrik, 2016**

Dokumenti **“Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”** u hartua në kuadrin e bashkëpunimit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit me UNICEF-in.

UNICEF–i mundësoi mbështetjen financiare dhe teknike. Nën kontributin dhe konsulencën e ekspertes ndërkombëtare, Sharon Lynn Kagan Ed.D nga Kolegji i Mësuesve, Universiteti i Kolumbisë, Qendra për Studimet e Fëmijës, Universiteti i Yale, ShBA, u hartua dokumenti i standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.

Grupi i punës u udhëhoq nga:

| | |
|---|---|
| Z. Gerti Janaqi | Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit |
| Znj. Aurela Zisi | Specialiste e Arsimit Fillor dhe Parashkollor, IZHA |
| Znj. Shqiponja Lamçe | Specialiste e Arsimit Parashkollor, MAS |
| Znj. Mirlinda Bushati | Specialiste e Edukimit dhe e Fëmijërisë së hershme UNICEF |
| Znj. Ermira Kurti | Eksperte në fëmijërinë e hershme, Partnerë për Fëmijët |

Në hartimin e standardeve kanë kontribuar pedagogë të Fakultetit të Shkencave sociale dhe të Fakulteve të mësuesisë, specialistë te IZHA-s, specialistë të arsimit parashkollor pranë drejtorive arsimore rajonale, mësues dhe drejtues të arsimit parashkollor, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile etj., ndër të cilët Edlira Sina, Florian Kulla, Vasilika Shtëpani, Livia Nano, Ermelinda Ikonomi, Besjona Dede, Eniana Veli, Nikolin Gërmenji, Gerda Sula, Majlinda Xhamo, Alda Kondakçiu, Lindita Lutaj, Elda Hallkaj, Sarie Hafizi, Anjeza Vila, Mirela Kondili, Jonida Matohiti, Flovia Selmani, Silva Haxhiaj, Donika Naqi, Marina Ndrio, Alketa Braka, Natasha Ismailaj, Vjollca Duka, Enkelejda Hanmja, Vjollca Krymi.

# TABELA E PËRMBAJTJES


TABELA E PËRMBAJTJES ..... 3

HYRJE ..... 6

PSE STANDARDE ZHVILLIMI DHE TË NXËNI? ..... 7

PARIMET QË JANË MBAJTUR PARASYSH PËR HARTIMIN E STANDARDEVE ..... 8

ORGANIZIMI I STANDARDEVE ..... 11

PROCESI I HARTIMIT TË STANDARDEVE ..... 12

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI FUSHAT E STANDARDEVE ..... 13

FUSHA: SHËNDETI, MIRËQËNIA FIZIKE DHE ZHVILLIMI MOTORIK ..... 21

Përshkrimi i fushës ..... 21

1.1 ZHVILLIMI FIZIK ..... 22

1.1.1 Zhvillimi motorik ..... 22

1.1.2 Zhvillimi sensomotorik ..... 22

1.2 SHËNDETI, KUJDESI DHE HIGJIENA PERSONALE ..... 22

1.2.1 Shëndeti, kujdesi dhe higjena personale ..... 22

1.2.2 Siguria personale ..... 22

1.3 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE ..... 25

1.4 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ..... 26

FUSHA: ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL ..... 39

Përshkrimi i fushës ..... 39

2.1 II.1 ZHVILLIMI SOCIAL ... 41
2.1.1 Ndërveprimi me të rriturit ... 41
2.1.2 Ndërveprimi me bashkëmoshatarët ... 41
2.1.3 Përshtatja e sjelljes sociale ... 41
2.2 ZHVILLIMI EMOCIONAL ... 41
2.2.1 Koncepti për veten ... 41
2.2.2 Shprehja dhe menaxhimi i emocioneve ... 41
2.2.3 Vetëkontrolli ... 41
2.3 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE ... 42
2.4 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ... 43
FUSHA: ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURI TË PËRGJITHSHME ... 56
Përshkrimi i fushës ... 56
3.1 Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve ... 57
3.2 Zhvillimi matematikor ... 57
3.3 Zhvillimi Shkencor ... 57
3.4 Njohja sociale ... 57
3.5 Zhvillimi Artistik ... 57
3.6 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE ... 58
3.7 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ... 60
FUSHA: ZHVILLIMI GJUHËSOR, LEXIMI DHE SHKRIMI ... 83
Përshkrimi i fushës ... 83
4.1 Të dëgjuarit dhe të folurit ... 83
4.2 Të lexuarit ... 83
4.3 Të shkruarit ... 83
4.4 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE ... 85

4.5 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ..... 85
FUSHA: PËRQASJET NDAJ TË NXËNIT ..... 98
Përshkrimi i fushës ..... 98
5.1 Kurioziteti dhe interesi ..... 99
5.2 Iniciativa ..... 99
5.3 Këmbëngulja dhe vëmendja ..... 99
5.4 Krijimtaria dhe imagjinata ..... 99
5.5 Reflektimi dhe interpretimi ..... 99
5.6 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE ..... 100
5.7 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ..... 101

# HYRJE

Shqipëria është në procesin e zhvillimit të një modeli gjithëpërfshirës dhe të integruar të arsimit parashkollor, në të cilin kombinohen natyrshëm procesi i edukimit, i kujdesit shëndetësor, i arsimimit, i lojës së fëmijëve dhe i kujdesit profesional ndaj zhvillimit të tyre. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka zënë vendin e saj të rëndësishëm edhe në planin strategjik, në të cilin Ministria e Arsimit dhe e Sportit ka përcaktuar qëllimet dhe pritshmëritë për të rritur dhe zhvilluar më tej komponentët përbërës të këtij niveli edukimi.

Gjithashtu, ndërhyrjet rrënjësore për të rritur cilësinë e edukimit dhe të mësimdhënies në këtë nivel të sistemit arsimor parauniversitar po paraprihen nga politikat e reja që po ndërmerr MAS-i, të tilla si:

- përgatitja e të gjitha kushteve për ta bërë arsimin për moshën 5-6-vjeçare të detyruar;
- zgjatja e arsimit të detyruar nga 9 në 10 vjet, i cili do të fillojë me vitin përgatitor;
- përafrimi i kurrikulës së re të arsimit parashkollor me kurrikulën e Kosovës, në kuadrin e përafrimit dhe të unifikimit të kurrikulave të arsimit parauniversitar të të dyja vendeve.

Në thelb të kësaj ndërhyrjeje do të mbetet sigurimi që të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, aftësie dhe etnie të kenë qasje të barabartë në shërbimet e ofruara, të nxitet dhe promovohet një qasje cilësore edukative me fëmijët përmes rritjes së ndërgjegjësimit mbarëkombëtar mbi rëndësinë e madhe të investimit në arsimin parashkollor.

Dokumenti i hartuar i standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç fokusohet në qasjen e re të bazuar në kompetenca dhe pritet të ndikojë në mënyrë mjaft pozitive te të gjithë përdoruesit e tij. Duke pasur në qendër fëmijët dhe duke u hartuar për ta, ky dokument paraqet arritjet e fëmijëve në periudha të caktuara moshore në fusha të ndryshme zhvillimi.

Duke marrë në konsideratë që është një dokument që u referohet të gjithë fëmijëve në Shqipëri, secili aktor mund t’i shfrytëzojë standardet me qëllimin kryesor - mbështetjen e zhvillimit më të mirë të fëmijëve parashkollorë.

# PSE STANDARDE ZHVILLIMI DHE TË NXËNI?

Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijërisë së hershme i referohen moshës së fëmijëve nga 3-6 vjeç. Këto standarde përshkruajnë sjelljet, aftësitë dhe njohuritë që duhet të kenë ose të jenë të aftë t'i tregojnë fëmijët e kësaj grupmoshe. Standardet përcaktojnë çfarë mund dhe janë në gjendje të bëjnë, të thonë dhe të demonstrojnë fëmijët gjatë rritjes, zhvillimit dhe kalimit nga njëra grupmoshë në tjetrën.

Përcaktimi i standardeve, i treguesve dhe i strategjive për përmbushjen e tyre ka për qëllim edukimin dhe transmetimin e vlerave njerëzore dhe të cilësive më të mira të popullit shqiptar, si: krenaria kombëtare, bashkëpunimi, ndihma, respektimi i të tjerëve, empatia, ndershmëria, dashuria, vullneti, këmbëngulja, menaxhimi i emocioneve, toleranca, mirëkuptimi, diversiteti etj.

Dokumenti i standardeve do t’u shërbejë:

- politikëbërësve, të cilët mund t'i përdorin standardet si një udhërrëfyes në hartimin e politikave mbështetëse për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme;
- fakulteteve të mësuesisë, të cilat mund t'i përdorin këto standarde si një kornizë për hartimin e kurrikulave bashkëkohore për përgatitjen e mësuesve/eve të arsimit parashkollor;
- specialistëve të kurrikulës për hartimin e një kurrikule cilësore parashkollori;
- drejtuesve/eve të institucioneve parashkollore për të krijuar një mjedis që mundëson zbatimin e këtyre standardeve;
- mësuesve/eve të parashkollorit për të mbështetur zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve nëpërmjet mësimeve tematike, veprimtarive praktike dhe lojërave në përshtatje me treguesit e standardeve të fushave të zhvillimit;
- prindërve të fëmijëve parashkollorë për të mësuar çfarë ndodh me rritjen e fëmijës dhe cila është kurba e zhvillimit të tij/të saj sipas fushave të përcaktuara.

Dokumenti i standardeve **nuk** ka për qëllim:

- të përdoret thjesht si një listë kontrolli për të vlerësuar fëmijët;

- të përdoret për vlerësimin apo diagnostikimin e fazave të zhvillimit të fëmijëve;
- të përdoret për të vlerësuar cilësinë e punës së mësuesve/eve të arsimit parashkollor;
- të zëvendësojë kurrikulën e parashkollorit;
- të përdoret për të mospranuar në institucionin e arsimit parashkollor një fëmijë;
- të përdoret për të krijuar sisteme dënimi apo shpërblimi për fëmijë apo për stafin edukativ;
- të ngurtësojë dhe të mbajë të lidhur mësuesit/et vetëm rreth treguesve të dhënë.

## PARIMET QË JANË MBAJTUR PARASYSH PËR HARTIMIN E STANDARDEVE

Pavarësisht renditjes së fushave dhe të standardeve, të gjitha fushat e zhvillimit dhe të të nxënit janë të rëndësishme. Proceset e zhvillimit dhe të të nxënit ndjekin njëra-tjetrën dhe ndikohen nga faktorë të ndryshëm ekonomikë, socialë e kulturorë. Zhvillimi dhe të nxënët vijnë si rezultat i arritjes së pjekurisë së fëmijës në një moshë të caktuar me përvojën e fituar gjatë rritjes. Fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme, por loja dhe eksplorimi mbeten veprimtaritë kryesore prej të cilave mësojnë fëmijët e kësaj grupmoshe. Përvoja që fitojnë fëmijët nëpërmjet lojës shërben si nxitëse për përfitimin e njohurive të reja, për zhvillimin e aftësive si dhe për t'i aftësuar që të tregojnë kuriozitet dhe krijimtari.

Hartimi i dokumentit të standardeve është bazuar në parimet e mëposhtme të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme.

- **Të mësuarit dhe zhvillimi i fëmijërisë së hershme janë shumëdimensionale.** Fushat e zhvillimit janë të ndërlidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Kjo nënkupton që zhvillimi i fëmijës në një fushë ndikon zhvillimin e tij/e saj edhe në fushat të tjera. Prandaj, fushat e zhvillimit nuk mund të konsiderohen si të ndara dhe të izoluara nga njëra-tjetra, por duhen parë si pjesëza të një të tëre. Ndërveprimi dinamik i tyre duhet të merret parasysh nga i rrituri, në mënyrë që fëmijës t’i jepet mundësi që të zhvillojë potencialin e vet në secilën prej tyre.

- **Fëmijët e vegjël janë të pajisur me aftësi e kompetenca të veçanta.** Të gjithë fëmijët janë potencialisht të aftë për të arritur rezultate pozitive në zhvillimin e tyre. Pavarësisht nga prejardhja dhe përvojat që kanë, mësuesit/et e arsimit parashkollor punojnë në përputhje me mundësitë e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve, por edhe duke u ofruar përvoja sfiduese, nëpërmjet të cilave nxitet progresi zhvillimor dhe interesi i çdo fëmije për të mësuar dhe përvetësuar njohuri dhe aftësi të reja. Është e rëndësishme të kuptohet nga i rrituri që për të gjithë fëmijët e vegjël duhet të ketë pritshmëri të mëdha, në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Nëse të rriturit i kanë pritshmëritë të pakta për fëmijët, edhe rezultatet do të jenë më të vogla, duke rrezikuar frenimin e zhvillimit të tyre potencial.
- **Fëmijët janë individë të cilët zhvillohen me ritme të ndryshme.** Çdo fëmijë është unik. Çdo fëmijë rritet dhe zhvillon aftësitë dhe kompetencat e veta në bazë të ritmit individual. Mësuesit/et e arsimit parashkollor duhet të njohin mirë karakteristikat unike zhvillimore të moshës parashkollore dhe duhet të jenë të afta ta planifikojnë kurrikulën në përputhje me përmbushjen e nevojave të çdo fëmije, sipas zhvillimit që kanë.

  Disa fëmijë mund të kenë vonesa të identifikuara në një fushë të caktuar zhvillimi, vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuar. Mësuesit/et e arsimit parashkollor i përshtasin pritshmëritë e përcaktuara në standardet e parashkollorit në përputhje me zhvillimin e këtyre fëmijëve. Plani edukativ individual (PEI) i pasqyron këto përshtatje në mënyrë që fëmijët të mbështeten për të përmbushur standarde të veçanta të arsimit parashkollor.

  Pra, kjo NUK do të thotë që për këta fëmijë duhen hartuar standarde të tjera. Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit janë të njëjta për të gjithë fëmijët, por rruga, mënyra dhe koha që duhet në dizpozicion për t'i përmbushur ato ndryshon nga njëri fëmijë te tjetri.

- **Fëmijët i demonstrojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat në çdo fushë zhvillimi.** Nuk duhet të pritet që të gjithë fëmijët e një grupmoshe të arrijnë t'i përmbushin standardet në të njëjtën kohë apo t'i tregojnë aftësitë dhe kompetencat që zotërojnë në të njëjtën shkallë zhvillimi. Fëmijët mund të tregojnë se janë më të prirur dhe më të zhvilluar në disa fusha zhvillimi ndërkohë që mund të tregojnë që kanë vështirësi apo kanë një zhvillim më të ngadaltë në të tjera fusha zhvillimi. Parë në këtë këndvështrim, mësuesit/et e arsimit parashkollor duhet të njohin individualitetin e çdo fëmije, të planifikojnë dhe të zhvillojnë

veprimtari duke iu referuar pikave të forta dhe ta ndihmojnë të ecë e të përparojë në fushat më sfiduese (në ato që kanë më shumë vështirësi). Nëpërmjet kësaj strategjie, fëmijët do të bëjnë hapa të vegjël progresi drejt përmbushjes së standardeve të edukimit parashkollor në secilën fushë, përfshirë këtu edhe ato fusha në të cilat paraqesin vështirësi.

- **Fëmijët e vegjël mësojnë nëpërmjet ndërveprimit aktiv me mjedisin që i rrethon, qoftë kur ky ndërveprim nis prej tyre apo kur nxitet nga të rriturit.** Fëmijët zhvillohen dhe mësojnë më së miri duke u ballafaquar me sfida. Në këtë ballafaqim i rrituri është vetëm orientues, i cili nuk pengon nismat dhe kreativitetin/krijimtarinë e fëmijëve, përkundrazi i nxit ata vazhdimisht në këtë drejtim duke krijuar një mjedis sa më motivues. Sugjerohet që sfidat të jenë spontane dhe sa më të natyrshme pasi të mësuarit buron nga përvoja jetësore e vetë fëmijës.
- **Prindërit janë edukatorët e parë të fëmijëve të vegjël.** Prindërit janë edukatorët e parë dhe kryesorë të fëmijës dhe si të tillë ata kanë mundësinë dhe pushtetin që të ndihmojnë fëmijët e tyre të rriten, të edukohen dhe të zhvillohen në mënyrë të shëndetshme. Prandaj përfshirja e tyre në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës përfshirë këtu edhe në arsimin parashkollor është shumë e rëndësishme. Vetëm në këtë mënyrë fëmijët kanë mundësi të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në jetë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore, sociale, fizike, mendore, krijuese dhe intelektuale.
- **Fëmijët mësojnë më mirë kur ndihen të mbrojtur dhe të sigurtë.** Kur marrëdhëniet që ndërtojnë fëmijët janë të sigurta e të qëndrueshme, kur ndërveprimi kopsht familje është pozitiv, atëherë fëmijët rriten të shëndetshëm në të gjitha aspektet.

**Fëmijëria e hershme është një periudhë e rëndësishme në jetën e çdo fëmije.** Studimet kanë treguar që përgatitja e fëmijëve për në shkollë fillore fillon shumë më herët sesa kur ata janë pesëvjeçarë. Në fakt kjo përgatitje fillon që nga lindja dhe zgjat gjatë gjithë periudhës së fëmijërisë së hershme. Stimulimet dhe ndërhyrjet e hershme janë shumë të rëndësishme dhe të pazëvendësueshme tek fëmijët dhe efekti i tyre reflektohet fuqishëm në periudhat e mëvonshme të zhvillimit. Nga ana tjetër, të gjithë fëmijët kanë potencial të arrijnë pjesën më të madhe të standardeve për një moshë të caktuar, sigurisht me stimulim, nxitje, mbështetje dhe udhëzime përkatëse. E thënë ndryshe, që një fëmijë të rritet dhe të zhvillohet ka nevojë jo vetëm për mbrojtje, ushqim dhe kujdes

shëndetësor, por edhe për ndërveprim, nxitje, siguri, dashuri dhe proces të mësuari nëpërmjet eksplorimit të mjedisit në të cilin ai rritet.

# ORGANIZIMI I STANDARDEVE

Fëmija zhvillohet si tërësi, ndaj mbivlerësimi apo nënvlerësimi i cilësdo fushe zhvillimore është i gabuar, sepse fëmija nuk zhvillohet në mënyrë të fragmentuar. Prandaj edhe ndarja në mes fushave në këtë dokument është kryesisht formale, pasi ashtu si zhvillimi i fëmijës është tërësor edhe fushat e veçanta të zhvillimit duhet të shikohen si pjesë e një të tëre, efikasiteti i të cilave kryesisht varet nga niveli i integrimit në mes tyre.

Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç trajtojnë këto fusha zhvillimi:

- **Shëndeti, mirëqënia fizike dhe zhvillimi motorik**
- **Zhvillimi social dhe emocional**
- **Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi**
- **Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme**
- **Përqasjet ndaj të nxënit**

Për secilën fushë është bërë një përshkrim i plotë i kuptimit, i përmbajtjes dhe i veçorive të saj. Më tej, jepen nënfushat, për të cilat jepet kuptimi i tyre i ngushtë dhe standardet përkatëse. Për secilin standard, jepen treguesit për atë që dinë dhe janë në gjendje të bëjnë fëmijët në grupmosha të ndryshme nga 3-6 vjeç.

Mësueset e atashuara pranë grupeve të punës, punuan si grup dhe përcaktuan strategji, veprimtari, lojëra, materiale e mjete didaktike për përmbushjen e treguesve të secilit standard.

# PROCESI I HARTIMIT TË STANDARDEVE

Në këtë fazë të reformës kurrikulare, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, me mbështetjen e UNICEF-it ngriti një grup të madh pune me ekspertë të fushës së fëmijërisë së hershme, për rishikimin e standardeve të deritanishme dhe për hartimin e standardeve të mbështetura në praktikën bashkëkohore dhe të zbatueshme në kontekstin shqiptar. Falë kontributit dhe konsulencës së ekspertes ndërkombëtare, Sharon Lynn Kagan Ed.D nga Kolegji i Mësuesve, Universiteti i Kolumbisë, Qendra për Studimet e Fëmijës, Universiteti i Yale, ShBA, u hartua dokumenti i standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.

Me mbështetjen e UNICEF-it, u mundësua që ekspertja ndërkombëtare të zhvillonte një trajnim treditor, në datat 22-24 korrik 2014 me grupin e hartuesve të standardeve. Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga MAS-i, IZHA, ISHA, DAR-et, pedagogë universitetesh dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme që veprojnë në fushën e fëmijërisë së heshme, mësuese dhe drejtues të institucioneve të arsimit për fëmijë 3-6 vjeç.

Në trajnim u bë një hyrje dhe një vështrim i përgjithshëm për standardet e zhvillimit dhe të të mësuarit në fëmijërinë e hershme, si dhe u dhanë orientime për vendimet kryesore që do të merrte grupi i punës për hartimin e standardeve, sipas llojeve dhe përshkrimit të tyre, përzgjedhjen e grupeve të punës, drejtimin e tyre, hartimin e parimeve udhëzuese, çështjet që duhen marrë në konsideratë gjatë shkrimit të standardeve që kanë lidhje me fushat e standardeve dhe nënfushat e tyre, përshkrimin dhe përcaktimin e treguesve dhe të aktiviteteve të të nxënit, vlefshmërinë e standardeve, si dhe pse duhen bërë etj. Me ndihmën e konsulentes ndërkombëtare, grupi i punës përcaktoi fushat e standardeve:

- Shëndeti, mirëqënia fizike dhe zhvillimi motorik
- Zhvillimi social dhe emocional
- Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi
- Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme
- Përqasjet ndaj të nxënit

Hartimi i standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit për fushat e sipërpërmendura u mbështet në studimin e një literature të pasur shqiptare dhe të huaj. Për hartimin e standardeve të fushës, grupet e punës morën në shqyrtim standardet e vendeve të rekomanduara nga ekspertja ndërkombëtare, Sharon Lynn Kagan, por jo vetëm.

## NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI FUSHAT E STANDARDEVE

**I.** ***SHËNDETI, MIRËQËNIA FIZIKE DHE ZHVILLIMI MOTORIK***. Standardet e kësaj fushe kanë lidhje me treguesit e zhvillimit fizik të fëmijëve 3-6 vjeç. Vetë këta tregues kanë lidhje me aftësitë e fëmijëve për të përdorur muskujt e duarve, koordinimin sy-dorë, muskujt e mëdhenj, nëpërmjet të cilës fëmijët realizojnë prekjen dhe manipulimet me objekte të ndryshme, kryejnë ecje, lëvizje dhe veprimtari të tjera fizike. Gjithashtu, standardet e kësaj fushe lidhen edhe me praktika të shëndetshme të higjienës, të cilat duhet të trajtohen si procedura rutinë në regjimin ditor të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, siç janë të ushqyerit, kujdesi për veten etj.

Nënfushat e kësaj fushe janë:

**I.1 Zhvillimi fizik**

**I.2 Shëndeti, kujdesi dhe higjiena personale**

**II.** ***ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL***. Standardet për këtë fushë përfshijnë sjellje dhe veprime që reflektojnë rritjen dhe zhvillimin emocional të fëmijëve, aftësitë e tyre për të hyrë në komunikim dhe për të krijuar marrëdhënie me bashkëmoshatarët, me mësuesit dhe të rritur të tjerë.

Nënfushat e kësaj fushe janë:

**II.1 Zhvillimi social**

**II.2 Zhvillimi emocional**

**III.** ***ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURI TË PËRGJITHSHME***. Standardet e kësaj fushe janë të lidhura me proceset njohëse të cilat mundësojnë të nxënët e çdo fëmije dhe fitimin e njohurive për botën që e rrethon. Shprehitë e fëmijëve në aspektin e zhvillimit njohës janë të lidhura me aftësitë e fëmijëve për të mbajtur mend, për të kuptuar e përdorur gjuhën e simboleve e të shenjave, për të mbledhur dhe përdorur informacionin, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të zhvilluar aftësitë për të arsyetuar dhe për të zgjidhur problemet, si dhe për të zhvilluar krijimtarinë dhe iniciativën. Treguesit e standardeve përcaktojnë mënyrën se si fëmija përfshihet në një aktivitet të të nxënit, duke mësuar koncepte, duke formuar ide dhe duke krijuar simbole, përmes aktiviteteve të ndërmarra prej vetë atij.

Nënfushat janë:

**III.1 Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve**

**III.2 Zhvillimi matematikor**

**III.3 Zhvillimi Shkencor**

**III.4 Njohja sociale**

**III.5 Zhvillimi Artistik**

**IV.** ***ZHVILLIMI GJUHËSOR, LEXIMI DHE SHKRIMI***. Standardet e kësaj fushe reflektojnë njohuritë dhe shprehitë kryesore që fiton fëmija me rritjen dhe zhvillimin në lidhje me të shprehurit, komunikimin me të tjerët, të lexuarit e të shkruarit. Në fokus të kësaj fushe janë aftësitë që kanë fëmijët për të shprehur veten, idetë dhe mendimet e tyre, fjalori që zotërojnë, njohja e shkronjave, drejtshqiptimi i tingujve, aftësitë për të dalluar gjuhën e folur dhe të shkruar etj.

Nënfushat e kësaj fushe janë:

**IV.1 Të dëgjuarit e të folurit**

**IV.2 Të lexuarit**

**IV.3 Të shkruarit**

**V.** ***PËRQASJET NDAJ TË NXËNIT.*** Standardet e kësaj fushe përqendrohen në sjelljet, veprimet, parakushtet e domosdoshme dhe qëndrimet bazë që fiton fëmija gjatë rritjes, gjatë fitimit të pëvojave të të nxënit dhe në marrëdhënie me të tjerët. Këto aktivitete të nxitura prej vetë fëmijës, brenda kontekstit social në të cilin ai bën pjesë, bëjnë të mundur që ai të përfshihet natyrshëm në përvoja interesante, të mbajë përgjegjësi, të zhvillojë aftësitë vëzhguese, kuriozitetin dhe dëshirën për të njohur gjithçka që e rrethon. Gjithashtu, veprimtaritë në të cilat përfshihet fëmija e ndihmojnë të ndërtojë kuptimin për botën që e rrethon, duke qëndruar i përqendruar dhe duke zhvilluar dëshirën për të nxënë, përmes shfaqjes së kureshtjes, ndjenjës së përgjegjësisë, iniciativës për të krijuar, për të marrë vendime dhe përmes këmbënguljes. Nëse aftësi të tilla nxiten në fëmijërinë e hershme, atëherë do të “ prodhojmë” fëmijë të gatshëm për të hyrë në shkollë, e për t’u përballuar me përvojat e reja të të nxënit të ofruar prej saj.

Nënfushat e kësaj fushe janë:

**V.1 Kurioziteti dhe interesi**

**V.2 Iniciativa**

**V.3 Këmbëngulja dhe vëmendja**

**V.4 Kreativiteti dhe imagjinata**

**V.5 Reflektimi dhe interpretimi**

## ORGANIZIMI I STANDARDEVE SIPAS FUSHAVE:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Fusha: Shëndeti, mirëqënia fizike dhe zhvillimi motorik** | **I.1 Zhvillimi fizik** | **I.1.1 Zhvillimi motorik** | I.1.1.a. Zhvillimi i motorikës së madhe | **Standardi 1**. Fëmija koordinon muskujt për të zhvilluar motorikën e madhe, me qëllim realizimin e lëvizjes. |
| | | | I.1.1.b. Zhvillimi i motorikës fine | **Standardi 2**. Fëmija përdor gishtat dhe duart për qëllime e manipulime të ndryshme. |
| | | **I.1.2 Zhvillimi senso-motorik** | | **Standardi 3**. Fëmija përdor shqisat (të nuhaturit, të prekurit, të parët, të shijuarit, të dëgjuarit) gjatë ndërveprimit me mjedisin dhe objektet që e rrethojnë. |
| | **I.2 Shëndeti, kujdesi për veten dhe higjiena personale** | **I.2.1 Shëndeti, kujdesi për veten dhe higjiena personale** | | **Standardi 4**. Fëmija konsumon ushqime të pasura me kalori.<br>**Standardi 5**. Fëmija demonstron aftësi për kujdes personal dhe kushte të mira higjienike |
| | | **I.2.2 Siguria personale** | | **Standardi 6**. Fëmija demonstron aftësi për të shmangur objekte të dëmshme dhe situata të rrezikshme që mund ta lëndojnë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha: Zhvillimi** | | **II.1.1 Ndërveprimi me të rriturit** | **Standardi 1.** Fëmija ndërvepron lehtësisht me të rriturit që njeh.<br>**Standardi 2.** Fëmija kërkon ndihmë nga i rrituri kur ka nevojë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | II.1 Zhvillimi social | | **Standardi 3.** Fëmija dallon personat e njohur nga personat e panjohur. |
| | | **II.1.2 Ndërveprimi me bashkëmoshatarët** | **Standardi 4.** Fëmija krijon marrëdhënie shoqërore dhe bashkëpunon me bashkëmoshatarët. |
| | | **II.1.3 Përshtatja e sjelljes sociale** | **Standardi 5.** Fëmija kupton sjellje të ndryshme dhe ndikimin e tyre (pozitiv dhe negativ).<br>**Standardi 6.** Fëmija merr përgjegjësi, negocion dhe merr pjesë në marrjen e vendimeve.<br>**Standardi 7.** Fëmija përshtatet në mjedise të ndryshme.<br>**Standardi 8.** Fëmija shfaq empati përkundrejt të tjerëve. |
| | **II.2 Zhvillimi emocional** | **II.2.1 Koncepti për veten** | **Standardi 9.** Fëmija mban dhe zhvillon qëndrim pozitiv për veten, kupton se është unik dhe ndihet krenar për arritjet e tij/e saj. |
| | | **II.2.2 Shprehja dhe menaxhimi i emocioneve** | **Standardi 10.** Fëmija shpreh dhe menaxhon në mënyrën e duhur sjelljen dhe emocionet. |
| | | **II.2.3 Vetëkontrolli** | **Standardi 11.** Fëmija shfaq aftësi vetëkontrolli në punë individuale dhe në grup. |
| **Fusha: Zhvillimi** | **III.1 Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve** | **Standardi 1:** Fëmija zbulon lidhjet mes shkakut dhe pasojës.<br>**Standardi 2:** Fëmija vëzhgon, krahason dhe vlerëson ngjarje dhe veprime.<br>**Standardi 3:** Fëmija kërkon zgjidhje të shumëfishta për detyrat dhe problemet. | |

| | | |
|---|---|---|
| | | **Standardi 4:** Fëmija përdor simbole për të paraqitur objekte. |
| | **III.2 Zhvillimi matematikor** | **Standardi 5:** Fëmija shfaq interes për numrat dhe numërimin.<br><br>**Standardi 6:** Fëmija identifikon dhe emërton format.<br><br>**Standardi 7**: Fëmija rendit, grupon, klasifikon dhe i organizon objektet duke u nisur nga madhësia, pesha, lartësia, gjatësia dhe vëllimi.. |
| | **III.3 Zhvillimi shkencor** | **Standardi 8:** Fëmija mbledh informacione për mjedisin dhe botën që e rrethon nëpërmjet vëzhgimit dhe hulumtimit, duke përdorur instrumente dhe metoda të ndryshme.<br><br>**Standardi 9:** Fëmija përfshihet në procesin e eksplorimit shkencor, bën dhe teston hipoteza të thjeshta, nxjerr konkluzione, bën parashikime.<br><br>**Standardi 10:** Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës së gjallë.<br><br>**Standardi 11:** Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë. |
| | **III.4 Njohja sociale** | **Standardi 12:** Fëmija dallon nëse një ngjarje ka ndodhur në të kaluarën, po ndodh tani apo mund të ndodhë në të ardhmen.<br><br>**Standardi 13:** Fëmija demonstron njohuri për vendndodhjen, për marrëdhëniet midis njerëzve, vendeve dhe rajoneve.<br><br>**Standardi 14:** Fëmija kupton se marrëdhëniet midis njerëzve janë në funksion të shkëmbimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.<br><br>**Standardi 15**: Fëmija përdor në mënyrë të përshtatshme disa pajisje teknologjike dhe tregon ndikimin e tyre në jetën e përditshme.<br><br>**Standardi 16:** Fëmija kupton strukturën e familjes, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj. |

| | | |
|---|---|---|
| | | **Standardi 17:** Fëmija demonstron njohuri për komunitetin, ndërvarësinë midis njerëzve, rolet e ndryshme sociale dhe përgjegjësinë qytetare<br><br>**Standardi 18:** Fëmija dallon ndryshimet kulturore ndërmjet njerëzve dhe i pranon ato. |
| | **III.5 Zhvillimi artistik** | **Standardi 19:** Fëmija përdor artin për të shprehur atë çfarë di, mendon, beson dhe ndjen.<br><br>**Standardi 20:** Fëmija zhvillon njohuri dhe aftësi vlerësuese për artin. |

| | | |
|---|---|---|
| **Fusha: Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi** | **IV.1 Të dëgjuarit dhe të folurit** | **Standardi 1.** Fëmija dëgjon dhe merr informacion për botën që e rrethon.<br><br>**Standardi 2.** Fëmija tregon aftësi në rritje për të dëgjuar kur flasin të rriturit apo fëmijë të tjerë.<br><br>**Standardi 3.** Fëmija ua komunikon mendimet, ndjenjat apo ngjarjet që përjeton të rriturve dhe fëmijëve të tjerë.<br><br>**Standardi 4.** Fëmija drejtshqipton tingujt, shkronjat dhe fjalët më të përdorura. |
| | **IV.2 Të lexuarit** | **Standardi 5.** Fëmija shfaq interes për të lexuarit. |
| | **IV.3 Të shkruarit** | **Standardi 6.** Fëmija kupton qëllimin e shkrimit.<br><br>**Standardi 7.** Fëmija shfaq aftësi në rritje për të kuptuar vlerën e simbolit të fjalës e shkronjës, e më vonë vetë simbolin. |
| **Fusha: Përqasjet ndaj të nxënit** | **V.1 Kurioziteti dhe interesi** | **Standardi 1.** Fëmija shfaq kuriozitet të mësojë diçka të re.<br><br>**Standardi 2.** Fëmija shfaq interes për të përjetuar përvoja të reja. |
| | **V.2 Iniciativa** | **Standardi 3.** Fëmija shfaq iniciativë pa dhe në ndërveprim me të tjerët. |
| | **V.3 Këmbëngulja dhe vëmendja** | **Standardi 4.** Fëmija tregon këmbëngulje për të marrë pjesë në aktivitete, veprimtari edhe nëse gjatë zhvillimit të tyre përballet me vështirësi. |
| | **V.4 Kreativiteti dhe imagjinata** | **Standardi 5.** Fëmija përdor aftësitë krijuese dhe imagjinatën në aktivitetet e jetës së përditshme. |
| | **V.5 Reflektimi dhe interpretimi** | **Standardi 6.** Fëmija mëson nga përvojat individuale dhe i përdor njohuritë e fituara në situata të reja. |

# FUSHA: SHËNDETI, MIRËQËNIA FIZIKE DHE ZHVILLIMI MOTORIK

## Përshkrimi i fushës

Kur flasim për zhvillimin si një proces, nënkuptojmë “ndryshime që realizohen gjatë kohës në strukturën, mendimin dhe sjelljen e personit, si rezultat i ndikimit të mjedisit dhe faktorëve biologjikë”. Zhvillimi u referohet ndryshimeve në nivelin funksional dhe nivelin e kompleksitetit të këtyre ndryshimeve, kompleksitet që ndjek rregullin nga më i thjeshti te më i ndërlikuari. Rritja dhe zhvillimi janë dy procese të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Zhvillimi fizik dhe lëvizor është mjaft i vrullshëm në tre vjetët e parë të jetës së fëmijës, gjatë të cilave kockat dhe muskujt e fëmijës zhvillohen shumë. Gjithashtu edhe aftësitë e tyre koordinuese, të forcës apo ekuilibrit zhvillohen po kaq vrullshëm, duke bërë që ata të zhvillojnë me energji aktivitetet e tyre ditore. Ndërkohë në moshën 3-6 vjeç, për shkak të forcimit dhe maturimit të sistemit skeletor, trupi i fëmijëve parashkollorë merr një formë më të rregullt, me një pamje atletike, karakteristike për këta fëmijë. Aftësitë lëvizore të tyre bëhen më të rafinuara, lëvizjet janë më të koordinuara dhe aftësitë e ekuilibrit zhvillohen dukshëm. Të gjithë fëmijët hyjnë në periudhën parashkollore me një bagazh dhe llojshmëri të aftësive lëvizore të cilat i kanë përfituar dhe përsosur gjatë fëmijërisë së hershme të tyre, e në të cilat përfshihen qëndrimi i drejtë ulur, drejtqëndrimi dhe të ecurit. Gjatë viteve të para të jetës, fëmijët përsosin aftësitë e tyre lokomotore (të zhvendosjeve) si dhe aftësitë e tyre manipulative duke u bërë kështu të aftë të gjenden në ambientin e tyre. Me kalimin e kohës fillon të zhvillohet ajo që quhet strukturë e lëvizjeve të përgjithshme, e cila përfshin kërcimet, hedhjet, kapjet, vrapimet tashmë të mësuara.

**Rritja e fëmijës** nënkupton diçka më shumë se sa ndryshimet trupore, apo se rritja e tij/e saj fizike. Rritja kupton rritjen në madhësi trupore gjatë një periudhe të caktuar kohore. E thënë ndryshe, rritja është progresion i ndryshimeve të fëmijës në komponentë të tillë si: peshë, gjatësi, perimetër koke, bazuar në standardet e përcaktuara për një popullatë të caktuar. Rritja e fëmijës u referohet ndryshimeve specifike në strukturën trupore, ndryshime që kanë të bëjnë kryesisht me rritjen e peshës apo gjatësisë së fëmijës, rritjen e duarve apo këmbëve etj.

## Nënfushat dhe përshkrimi i tyre

## 1.1 ZHVILLIMI FIZIK

### 1.1.1 Zhvillimi motorik

#### 1.1.1.1 Zhvillimi i motorikës së madhe

#### 1.1.1.2 Zhvillimi i motorikës fine

### 1.1.2 Zhvillimi sensomotorik

## 1.2 SHËNDETI, KUJDESI DHE HIGJIENA PERSONALE

### 1.2.1 Shëndeti, kujdesi dhe higjena personale

### 1.2.2 Siguria personale

**Zhvillimi fizik** përfshin karakteristikat dhe cilësitë fizike. Zhvillimi fizik u referohet me kalimin e kohës ndryshimeve në nivelin funksional të strukturave trupore. Shëndeti i mirë fizik u jep fëmijëve energji dhe qëndrueshmëri që të marrin pjesë aktive në procesin e të mësuarit (për shembull, foshnjat, kur mësojnë të zvarriten ose të ecin, e rrisin mundësinë e tyre ta hulumtojnë hapësirën, e kështu nxisin edhe zhvillimin e tyre konjitiv).

**Zhvillimi motorik.** Fëmijët e kësaj moshe bëjnë hapa të mëdhenj në zhvillimin e aftësive motorike të mëdha, të vrapuarit, të kërcyerit, dhe atyre të vogla (fine) si: mbërthimi i kopsave, kopjimi i figurave, prerja me gërshërë etj.

Fëmija përdor shqisat (të parit, të dëgjuarit, të prekurit, të nuhaturit, të shijuarit) për rregullimin e lëvizjes. Lëvizjet e tyre janë më të koordinuara në ecje, në ngjitje, dhe në aktivitete të tjera që kërkojnë lëvizje më të mëdha të muskujve. Ata mund të ngasin një biçikletë me tri rrota apo të lëkunden në lëkundëse, duke mbajtur ritmin, të kapin një top të madh duke përdorur të dy duart dhe trupin e tyre. Në këtë moshë fëmijët mund të fitojnë zhdërvjelltësinë e gishtave duke arritur të vendosin pjesët e një pazlle në vendin e tyre, të mbajnë lapustilën me gishta e jo më me grusht, të formojnë topa me brumë ose plastelinë dhe forma të tjera, si p.sh:, një gjarpër me plasteline ose argjil, si dhe të zhvishen pa ndihmë.

**Motorika e madhe** përfshin reagimet e fëmijës në mënyrën e qëndrimit, në kontrollin e lëvizjeve të kokës, në mbajtjen e ekuilibrit, në kryerjen e lëvizjeve dhe të zhvendosjes së trupit nëpërmjet ecjes, vrapimit, kërcimit, ngjitjes, zbritjes, drejtpeshimit etj.

**Motorika fine** u referohet lëvizjeve që bëjnë muskujt e vegjël të duarve. Aftësitë motorike fine kanë të bëjnë me lëvizjet që prodhohen kryesisht nga një grup muskujsh të vegjël. Ato përdoren për të realizuar detyra të tilla si: mbajtja e lapsit për të vizatuar, mbajtja e gërshërës për të prerë një fletë, mbajtja e lapsave me ngjyra për të ngjyrosur, shkuarja e rruazave, e goglave ose e makaronave me vrimë të madhe në fill etj.

**Zhvillimi sensomotorik** ka të bëjë me koordinimin e shqisave me proceset motorike. Aftësitë sensomotore lidhen me zhvillimin e aftësive sensoremotorike për të përdorur organet e shqisave për të drejtuar një aktivitet. Një nga aspektet kryesore të zhvillimit sensormotorik është koordinimi sy-dorë. Fëmija e moshës 3-6 vjeç imiton tinguj të instrumentave muzikorë që dëgjon, e kthen shikimin e jo qafën për të parë diçka, i fut sendet në vrima të vogla, rendit goglat në numëratore, vizaton figurat që shikon me saktësi të madhe, me detaje, bën ndërtime me materiale të ndryshme duke përdorur fantazinë etj.

**Shëndeti, kujdesi për veten dhe higjiena personale**. Fëmijët e moshës parashkollore në përgjithësi janë mjaft të shëndetshëm, por mund të shfaqin edhe probleme shëndetësore. Sëmundje tipike të lehta, të cilat zakonisht zgjasin jo më shumë se 14 ditë që mund të prekin këtë moshë, përfshijnë ftohjet, kollitjet, dhe dhimbjet e stomakut. Sëmundjet e frymëmarrjes janë sëmundjet më të zakonshme të fëmijëve të kësaj moshë sepse mushkëritë e parashkollorëve ende nuk janë zhvilluar plotësisht. Shumica e sëmundjeve të fëmijërisë zakonisht nuk kërkojnë vëmendjen e mjekut ose kujdes infermieristik. Përveç kësaj, sëmundjet e lehta mund

t'i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësitë përballuese, veçanërisht se si të menaxhojnë dhimbjet fizike dhe ankthin e shkaktuar prej tyre. Gjithashtu ato mund t'i ndihmojë fëmijët të bëhen të ndjeshëm, të kuptojnë dhimbjet dhe ankthin e dikujt tjetër.

Aspekte thelbësore të shëndetit fizik janë higjiena e mirë personale dhe praktikat kryesore të kujdesit personal, duke përfshirë veprimtari të përditshme rutinë, si: larja e fytyrës, e duarve, e trupit, pastrimi i hundëve dhe i veshëve, higjiena e gojës etj. Gjithashtu, në çështjet e shëndetit dhe në kujdesin personal përfshihen edhe aftësitë e fëmijës për të bërë zgjedhje të shëndetshme në lidhje me ushqimin dhe praktikat e të ushqyerit. Për këtë fëmijët kanë nevojë të mbështeten dhe të nxiten për të bërë zgjedhjet më të mira e më të shëndetshme.

Fëmijët nxiten të kuptojnë rëndësinë e një higjiene të mirë personale dhe aplikimin e praktikave të shëndetshme, të kujdesit ndaj vetes, si dhe në zgjedhjen e duhur të ushqimeve të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e tyre.

**Siguria personale**. Siguria është një aspekt i rëndësishëm në mirëqënien e fëmijës. Kjo nënkupton zhvillimin e aktiviteteve që e bëjnë fëmijën të mbrohet nga situatat e rrezikshme dhe subsantancat e dëmshme. Fëmijët duhen ndihmuar të zhvillojnë aftësi për të mësuar rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes; të kuptojnë se kur është e nevojshme të kërkojnë ndihmë. Në këtë moshë fëmija zhvillon vetëdijen dhe aftësitë për t'u kujdesur për shëndetin dhe rregullat bazë të sigurisë, të tilla si: mbrojtja nga zjarri, lëvizja në rrugë, shmangia e objekteve të nxehta, e objekteve potencialisht të dëmshme, substancave dhe aktiviteteve të rrezikshme.

Fëmija në këtë moshë fillon të kuptojë nevojën për pushim dhe për aktivitete fizike. Përmirëson dukshëm aftësinë për të qetësuar veten. Mund të marrë pjesë në mënyrë aktive në lojëra, lojë në natyrë dhe forma të tjera të ushtrimeve që rrisin aktivitetin fizik. I provon vetë ushqimet e reja. Arrin t'u kërkojë të tjerëve të mos përfshihen në sjellje të rrezikshme, si psh: “Mos luaj duke gjuajtur me rërë”.

## 1.3 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **I.1 Zhvillimi fizik** | **I.1.1 Zhvillimi motorik** | I.1.1.a. Zhvillimi i motorikës së madhe | **Standardi 1**. Fëmija koordinon muskujt për të zhvilluar motorikën e madhe, me qëllim realizimin e lëvizjes. |
| | | I.1.1.b. Zhvillimi i motorikës fine | **Standardi 2**. Fëmija përdor gishtat dhe duart për qëllime e manipulime të ndryshme. |
| | **I.1.2.Zhvillimi sensomotorik** | | **Standardi 3**. Fëmija përdor shqisat (të nuhaturit, të prekurit, të parët, të shijuarit, të dëgjuarit) gjatë ndërveprimit me mjedisin dhe objektet që e rrethojnë. |
| **I.2 Shëndeti, kujdesi dhe higjiena personale** | I.2.1. Shëndeti, kujdesi dhe higjiena personale | | **Standardi 4**. Fëmija konsumon ushqime të pasura me kalori.<br>**Standardi 5**. Fëmija demonstron aftësi për kujdes personal dhe kushte të mira higjienike. |
| | I.2.2Siguria personale | | **Standardi 6**. Fëmija demonstron aftësi për të shmangur objekte të dëmshme dhe situata të rrezikshme që mund ta lëndojnë. |

## 1.4 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE

**Standardi 1. Fëmija koordinon muskujt për të zhvilluar motorikën e madhe, me qëllim realizimin e lëvizjes.**

**Treguesit për standardin 1**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Nget një biçikletë me tri rrota.<br>➦ Qëndron mbi një këmbë për 5-10 sekonda.<br>➦ Ngjitet dhe zbret shkallët, duke alternuar këmbët (me ndihmën e të rriturit).<br>➦ Ecën në një vijë (hapësirë) të drejtë.<br>➦ Kërcen përpara me këmbë të bashkuara.<br>➦ Përdor një rrëshqitëse në mënyrë të pavarur.<br>➦ Ecën dhe vrapon rreth pengesave, objekteve.<br>➦ Zvarritet në tunele të improvizuara, (p.sh.: poshtë tavolinës).<br>➦ Ngjitet tek një pajisje lodër.<br>➦ Kap një top të madh me dy duar dhe e | ➦ Kërcen me një këmbë dhe më vonë qëndron me një këmbë për 5-10 sekonda.<br>➦ Hipën dhe zbret shkallët, ndërsa mban një objekt në njërën ose në të dyja duart.<br>➦ Koordinon pjesët e trupit sipas lëvizjeve që bën.<br>➦ Vrapon më mirë dhe rrëzohet më pak.<br>➦ Vrapon dhe ndalon sipas komandave që i jepen: "Më shpejt!", "Më ngadalë!" "Kthehu mbrapa!" "Vazhdo përpara!" etj. | ➦ Nget një biçikletë me dy rrota.<br>➦ Qëndron dhe kërcen me një këmbë për 10 ose më shumë sekonda.<br>➦ Vrapon me siguri, kërcen dhe gjuan topin.<br>➦ Kapërcen pengesa, zvarritet, ecën në një tra të ulët ekuilibri, ngjit dhe zbret shkallët i sigurt dhe me vrap duke alternuar këmbët (një këmbë për një shkallë).<br>➦ Bën kapërdimje, për t'u hedhur e për t'u rrotulluar.<br>➦ Pozicionon trupin në përshtatje me veprimet që kryen (p.sh.: në imitime lëvizjesh).<br>➦ E gjuan në përgjithësi saktë një top të |

| | | |
|---|---|---|
| gjuan përpara.<br>➦ Kërcen me dy këmbë mbi objekte të vogla duke ruajtur ekuilibrin**.**<br>➦ Ecën duke mbështetur në tokë në fillim thembrën, më pas shputën dhe në fund gishtat e këmbës. | | madh në një pikë/ drejtim të caktuar. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë praktike për përmbushjen e treguesve të standardit 1**

- Improvizohet një korsi 2-3 m e gjatë dhe 30-40 cm e gjerë, në të cilën do të ecë fëmija.
- Shënohet në tokë një vijë e vijëzuar 3-5 m të gjatë dhe fëmija lëviz mbi të duke alternuar këmbët, duke kombinuar hedhjen e këmbëve me lëvizjen e krahëve etj.
- Realizohet ecja këmba-doras duke imituar lëvizjen e kafshëve të ndryshme, kalimin poshtë urës së improvizuar ose poshtë litarit që qëndron në lartësi 40-50 cm.
- Kalim pengesash të vendosura në largësi 1m dhe në lartësi 15-20 cm.
- Ecje nëpër birrila të vendosura në formë zigzagu.
- Ngjitje e zbritje nëpër shkallë me një tabaka në dorë.
- Improvizohet një tra ekuilibri për të bërë ushtrime ekuilibuese mbi të.
- Realizohet ecja në ekuilibër duke imituar lëvizjen e patës.
- Kapërdimje dhe rrotullime në një dyshek të shtruar mbi dysheme.
- Lojëra me topa të madhësive të ndryshme, për hedhje e pritje të topit.
- Kryhen kërcime pupthi duke imituar kërcimin e lepurushit.
- Kërcime pupthi me litar.
- Kërcim litari, tërheqje litari si marinari i anijes.

- Kërcime së gjati mbi dyshek.
- Ecje me hap të rregullt, kërcime, hedhje duke imituar kafshë të ndryshme.
- Ngritja në majë të gishtave për të imituar prekjen dhe këputjen e mollëve në pemë.
- Loja “Vigani, shkurtabiqi” “Kush e hedh topin më lart”.
- Ushtrim me muzikë, vrapime sipas komandave.
- Loja “Kush e zë i pari karrigen”.
- Lojëra lëvizore “Kush vonohet humbet vendin”, “Stafetë me objekte”, “Rrëzimi i shisheve etj.”.
- Lojë “Gjuaj në shenjë”, “Topi në kosh”.

**Standardi 2. Fëmija përdor gishtat dhe duart për qëllime e manipulime të ndryshme.**

**Treguesit për standardin 2**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bashkon pika dhe emërton figurat që krijohen.<br>➦ Vizaton forma rrethore.<br>➦ Kopjon shenjën (+)<br>➦ Fillon të mbajë një shkumës ose një laps si një i rritur.<br>➦ Ndërton një kullë me 6-9 kube të vegjël.<br>➦ Bën me plastelinë topa, objekte të stërgjatura etj. | ➦ Përdor njërën dorë në mënyrë të vazhdueshme për detyra që kanë të bëjnë me prerjen me gërshërë, vizatimin, ngjyrosjen etj.<br>➦ Vizaton veten me tri pjesë trupi.<br>➦ Vizaton forma të ndryshme gjeometrike, si rrethor, trekëndësh, katror etj.<br>➦ Vendos rrobat në vendin e duhur. | ➦ Përdor lehtësisht të dyja duart kur zhvillon një aktivitet, por demonstron vazhdimisht dominimin e njërës dorë.<br>➦ Përgjithësisht, vizaton trupin e njeriut me raporte të drejta mes pjesëve.<br>➦ Ngjyros saktë figurën brenda vijës kufizuese.<br>➦ Arrin të mbarojë shumë detyra që lidhen me kujdesin ndaj vetes në |

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Ndërton objekte të ndryshme me blloqe të mëdha.<br>➦ Menaxhon butonat e rrobave (me ndihmën e të rriturit).<br>➦ Ha vetë me lugë e pirun.<br>➦ Kthen njëra pas tjetrës faqet e librit ndërsa e shfleton atë.<br>➦ Në përgjithsi, vishet plotësisht me ndihmën e të rriturit.<br>➦ Vidhos dhe zhvidhos bullona, vida të mëdha te lodrat e veta.<br>➦ Prish dhe ndërton pazëll me 3-4 pjesë.<br>➦ Godet me çekiç "gozhdë" (apo thumba të imrovizuar), në një bukë peshku për koordinimin sy-dorë.<br>➦ Ngjit një pjesë të figurës në një karton dhe më pas ngjit dhe gjysmën tjetër për ta plotësuar.<br>➦ Kalon rruaza me vrimë të madhe në një tel të butë. | ➦ Mban në pozicionin e duhur lugën dhe pirunin gjatë ngrënies.<br>➦ Ngul gozhdë me çekiçin lodër.<br>➦ Ndërton një kullë me 10 kuba.<br>➦ Ndërton me pazëll një figurë me 6 pjesë.<br>➦ Hap dhe mbyll butonat e rrobave, por ka ende nevojë për ndihmë.<br>➦ Hedh dhe pret një tollumbac.<br>➦ Pret me gërshërë në vijë të drejtë 20 cm duke u larguar 3 mm.<br>➦ Mbush një enë të madhe me një enë të vogël. | mënyrë të pavarur.<br>➦ Derdh ujë nga njëra gotë në tjetrën dhe kontrollon sasinë që derdh.<br>➦ Shkruan në sipërfaqe të ndryshme me mjete të ndryshme, si laps, shkumës, lapustil apo penel.<br>➦ Kontrollon ritmin e të shkruarit, shpejt ose ngadalë, në varësi të muzikës që dëgjohet në sfond. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 2**

- Manipulime me brumë e plastelinë me gishta dhe duar.
- Manipulime me pjata, lugë e pirunj plastikë.
- Manipulime me materiale dhe mjete të riciklueshme.
- Prerje me gërshërë të vijave, figurave dhe formave të ndryshme.
- Prerje me gërshërë e formave të vizatuara.
- Realizime punimesh me mjete të trashësive të ndryshme.
- Futja e kutive te njëra-tjetra.
- Fryrja e tollumbaces.
- Mbush dhe zbraz kupa të madhësive të ndryshme.
- Ngulja e kunjave të shkrepses(të dhëmbëve) në trupin prej plasteline të iriqit.
- Stampime me duar të ngjyrosura me bojë.
- Ndërtime me kuba.
- Ndërtimi i shtëpisë me blloqe.
- Ndërtimi i rrugëve, shinave të trenit, murit me kube.
- Lojë me pazëll me 4-6 pjesë të mëdha për të prishur dhe ndërtuar figurën.
- “Përgatitja e derrkucit me patate”.
- Lojë me tollumbace ose top të lehtë plazhi.
- Lojëra simbolike “Në shtëpi”, ‘Në dyqan”etj.
- “Palosja e shamisë”.
- Garë “Kush e heq dhe e zhvesh i pari xhupin me butona/ zinxhirë”.
- “Në tavolinë”.

**Standardi 3. Fëmija përdor shqisat (të nuhaturit, të prekurit, të parët, të shijuarit, të dëgjuarit) gjatë ndërveprimit me mjedisin dhe objektet që e rrethojnë.**

**Treguesit për standardin 3**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Reagon fizikisht në mënyrë të përshtatshme me mjedisin ku ndodhet.<br>➦ Koordionon shkimin e të dy syve.<br>➦ Fillon t'i mbajë materialet në largësinë e duhur (por pasi ia kujton shpesh).<br>➦ Ndjek lëvizjen e objektit me sy dhe jo me kokë.<br>➦ E përqendron shikimin te një objekt pa i shtrënguar apo picëruar sytë.<br>➦ Çmbështjell sende të vogla.<br>➦ Përthyen (palos) letrën.<br>➦ Arrin të kapë një top pas vetes.<br>➦ Fillon të përshtasë lëvizjet me ritmin e muzikës që dëgjon. | ➦ Godet një top me diametër (15 deri në 20 cm).<br>➦ Kap një top të madh të hedhur nga një distancë e shkurtër.<br>➦ Shfaq gëzim, luan në mënyrë aktive duke kombinuar radhën, ose duke zbatuar rregullat e lojës (p.sh: te loja "Ngriva – shkriva", "Kukafshehti".<br>➦ U bindet rregullave të grupit në shumicën e rasteve.<br>➦ Reagon në mënyrë të përshtatshme kundrejt stimujve mjedisore (ulet ne gjunjë, lëviz shpejt për të shmangur pengesat, shmang erërat e këqija etj).<br>➦ Imiton kafshët duke lëvizur, duke riprodhuar tingujt etj.<br>➦ Kryen saktë koordinimet sy-dorë-objekt (kap një top në hedhje). | ➦ Rrit dukshëm saktësinë e objekteve që vizaton.<br>➦ Mban një gotë të mbushur me ujë ose lëng nëpër dhomë pa e derdhur atë.<br>➦ Kryen lëvizje të caktuara kur dëgjon një tingull ose drejtimin e caktuar, i dallon dhe i emërton saktë erërat me sy mbyllur etj.<br>➦ Ndryshon ritmin, drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjeve kur dëgjon lloje të ndryshme sinjalesh (nisur nga ngjyrat, tingujt, simbolet grafike etj.).<br>➦ Zgjedh të luajë një lojë në varësi të kushteve atmosferike (p.sh.: kur bie shi, kur fryn erë, kur ka borë etj.). |

| | | |
|---|---|---|
| | ➦ Hedh topin në drejtim të koshit. | |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 3**

- Dëgjimi dhe imitimi i tingujve dhe i zhurmave që dëgjohen në  mjedis.
- Mbështjellja e letrës në formë karameleje.
- Palosja e letrës.
- Hedhje e pritje topi.
- Veprimtari praktike për prerje me gërshërë.
- Përplasja e këmbëve sipas ritmit të muzikës.
- Loja “Njihe shokun nga zëri”.
- Garë: “Kush e hedh topin më larg”.
- Loja “Gjeje nëpërmjet shqisave”.
- Lojë muzikore “Lart në tavan, poshtë në dysheme”.
- Imitime tingujsh që lëshojnë kafshët.
- Tërheqje dhe shtyrje objektesh siaps komandave që i jepen.
- “Gjej rrugën e duhur në një labirinth”.
- Lojë “Hapa-dollapa”.
- Lojë “Treni në tunel”.
- Shfaqje dhe zhdukje objektesh për të rritur vëmendjen dhe përqendrimin.
- Lojë “Gjeje nga tingulli zhurma që bën; “Nuhate nga era që lëshon”.
- Lojë “Dalloje shokun nëpërmjet prekjes”.

**Standardi 4. Fëmija konsumon ushqime të pasura me kalori.**

**Treguesit për standardin 4.**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Ndihmon në vendosjen e ushqimeve në tryezë dhe merr pjesë në shtrimin e saj.<br>➦ Vendos me kujdes në tavolinë, pa e përplasur gotën e ujit ose shishen me lëng (nëse tavolina është në nivelin e fëmijës). | ➦ Ushqehet vetë me pirun e me lugë. Ndonjëherë përdor edhe thikën.<br>➦ Hedh qumësht ose lëng në gotë.<br>➦ Tregon se cilat ushqime nuk janë të shëndetshme dhe gjatë lojës me kukulla i përcjell këto mesazhe.<br>➦ Kupton me ndihmën e të rriturit efektin që ka përdorimi i disa ushqimeve ose mospërdorimi i tyre. | ➦ Konsumon ushqime të shëndetshme për trupin.<br>➦ Tregon funksionin primar të ushqimeve të caktuara (p.sh: qumështi forcon kockat.)<br>➦ Bën një listë ushqimesh për t'u blerë në pazar, por me ndihmën e të rriturit.<br>➦ Tregon përfitimet dhe rreziqet e ngrënies se ushqimeve të caktuara për trupin e njeriut.<br>➦ Dallon ushqimet që u përkasin grupeve të ndryshme ushqimore.<br>➦ Bën kujdes që të mos hajë ushqime të prishura; fillon të pyesë për datën e skadencës së tyre. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 4**

- Përgatitja e menusë ditore.
- Ndërtimi i piramidës ushqimore.
- Veçimi në dy shporta i ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme për trupin e njeriut.

- Sallata me frutat e stinës.
- Te këndi i shtëpisë: “Ushqej kukullën me ushqime të shëndetshme”.
- Përralla “Supa me barishte”.
- Tregimi “Sëmundja e Bardhit” – “Larja e frutave para ngrënies”.
- Vjersha “Kur vjen dreka”.
- Lojë didaktike “Shijo symbyllazi”.
- Lojë didaktike: “Treni i ushqimeve” – Renditja e ushqimeve sipas grupeve ushqimore.
- Lojë didaktike “Në dyqanin e ushqimeve”.

**Standardi 5. Fëmija demonstron aftësi për kujdes personal dhe kushte të mira higjienike**

**Treguesit për standardin 5**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Kujdeset për kryerjen në mënyrë të pavarur të nevojave të veta personale në tualet.<br>➦ Lan dhe fshin duart para ngrënies dhe pas tualetit (herë-herë të kujtuara nga i rrituri).<br>➦ Përdor shami letre dhe e hedh në koshin e plehrave pas përdorimit.<br>➦ Bashkëpunon me të rriturit në larjen e dhëmbëve. | ➦ Kujdeset për nevojat personale; shpesh kërkon të jetë vetëm në tualet.<br>➦ Lan pranueshëm trupin dhe dhëmbët, por ka nevojë për ndihmë (vëzhgim) të rregullt nga i rrituri.<br>➦ Vishet vetë, mbërthen susta e butona, mbërthen rripin, vesh këpucë me ngjitëse.<br>➦ Inatoset nëse gjatë veshjes nuk arrin dot të bëjë vetë diçka dhe e provon sërisht | ➦ Kryen vetë të gjitha nevojat personale.<br>➦ Kujdeset per larjen dhe shpëlarjen e gojës, të dhëmbëve pas vakteve ushqimore, pa ia kujtuar të tjerët.<br>➦ Lahet thuajse plotësisht vetë, por ka pak nevojë për ndihmë për të filluar.<br>➦ Vishet vetë plotësisht; mbërthen kopsat, hap dhe mbyll zinxhirat, kupton kur i ka veshur rrobat |

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Identifikon produktet e kujdesit të trupit (sapun, shampo, pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh etj.).<br>➦ Tregon kur ndjen simptoma sëmundjesh. | me kokëfortësi.<br>➦ Mund të ndajë, të palosë dhe të vendosë në dollap rrobat e veta të pastra, të varë peshqirin, të rregullojë dhomën.<br>➦ Lan dhëmbët kur ia kërkojnë.<br>➦ Mbulon gojën dhe hundën më dorë kur kollitet dhe teshtin.<br>➦ Kujdeset për të pastruar mjedisin ku qëndron. | mbrapsht etj.<br>➦ Në përgjithësi është i pakujdeshëm për rrobat; i lë ato të shpërndara gjithandej, ka shumë nevojë që dikush t'ia rikujtojë për t'i mbledhur e vendosur rrobat në vendin e duhur.<br>➦ Përdor shaminë kur i rrjedhin hundët, por shpesh i lë përgjysmë punët apo bën një punë pa kujdes.<br>➦ Tregohet i pavarur në higjienën personale (lan dhe than duart, mbulon gojën ndërsa kollitet ose teshtin, përdor në mënyrë të pavarur tualetin). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 5**

- Larja e duarve, e buzëve dhe e fytyrës, përdorimi i peshqirit personal.
- Larja e fytyrës, e qafës, e veshëve, e dhëmbëve, krehja e flokëve në mënyrë të pavarur.
- Radha e larjes së trupit.
- Përgatitja e kutisë së ndihmës së shpejtë.
- Përdorimi i shamisë kur kollitet ose kur teshtin.
- Veprimtari praktike në këndet, qendrat e aktivitetit për sistemimin e materialeve, të mjeteve dhe të lodrave.
- Bisedë me mjeken pediatre.
- Vjershë “Xhepi im i vogël”.

- Vjershë “Tani qaramani”.
- Vjershë “Hunda dhe shamia”.
- Vjershë  “Unë tani u rrita”.
- Tregimi “Dhëmbi i prishur”- Kujdesi për dhëmbët dhe higjiena e gojës.
- Tregim “Bardhoshi dhe 4 lepurushët”.
- Përralla “Arushi që nuk bënte banjë”.
- Lojë “Më i shkathti më i shpejti”.
- Lojë muzikore “Porsa zgjohem në mëngjes”.
- Kënga “Bleta dhe miza”.

**Standardi 6. Fëmija demonstron aftësi për të shmangur objekte të dëmshme dhe situata të rrezikshme që mund ta lëndojnë**

**Treguesit për Standardin 6**

| **Mosha 3-4 vjeç** | **Mosha 4-5 vjeç** | **Mosha 5-6 vjeç** |
|---|---|---|
| ➦ Mënjanon rreziqe të tilla siç është nxehtësia e sobës, thikën e mprehtë, briskun etj.<br>➦ Tregon nëse ka dhimbje ose ndonjë shqetësim tjetër.<br>➦ Fillon të kuptojë rreziqet që vijnë nga mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor.<br>➦ Fillon të kuptojë rreziqet nga lëvizja në | ➦ Dallon ndryshimin e ngjyrave të semaforit në rrugë dhe e di se duhet të kalojë kur ndizet drita jeshile për këmbësorët.<br>➦ Dallon disa shenja apo simptoma sëmundjesh dhe ua tregon ato më të rrituve.<br>➦ Kupton dhe shmang objektet që nuk mund të preken për shkak të | ➦ Kupton që disa sjellje janë të rrezikshme dhe mund t’i dallojë nëpërmjet simboleve apo fotove që mund të shohë (p.sh: ndalimi i duhanit, mosngarja e motorit ose e biçikletës pa kasketë, moslidhja e rripit të sigurimit në makinë, aeroplan etj.).<br>➦ Kontrollon rrugën për të shmangur |

| | | |
|---|---|---|
| shkallë, ngjitja në lartësi, vendet e rrëshqitshme etj.<br>➦ Tenton të evitojë disa rrezige.<br>➦ Dallon simbolet e zjarrfikësit, ambulancës, policisë.<br>➦ I mban lapsat në mënyrën e duhur për të shmangur aksidentet.<br>➦ Fillon të kuptojë që nuk duhet të prekë ose të marrë ilaçe pa ndihmën e të rriturve, gjithashtu di që ilaçi mund të japë efekt kur përdoret siç duhet.<br>➦ Ndjek rregullat kryesore të sigurisë në lëvizjet me makinë, në transport publik, biçikletë, kur ndodhet në parkun e lojërave, kur ngacmohet nga një i panjohur etj.<br>➦ Ulet në karrigen mbajtëse në makinë. | rrezikshmërisë që paraqesin, si thika, gërshërë etj. (duke ia rikujtuar shpesh i rrituri).<br>➦ Kupton se disa praktika janë të dëmshme e të rrezikshme për shëndetin (p.sh., pirja e duhanit, pirja e alkoolit, loja me shkrepse, prekja e gjakut të një personi tjetër etj).<br>➦ Di se cilët të rritur mund ta ndihmojnë në situata të rrezikshme.<br>➦ Shfaq interes për të mësuar si të reagojë në raste emergjencash si p.sh: në rastet e rënies së zjarrit.<br>➦ Di se ku të kërkojë ndihmë në situata të jashtëzakonshme (kur ka nevojë p.sh: për ndihmën e policisë, të zjarrfikëses, ambulancës apo të ndonjë familjari).<br>➦ Demonstron rregullat e sigurisë në një lojë dramatike (p.sh.: i tregon kukullës se si duhet t'i mbajë duart larg nga soba e nxehtë).<br>➦ Përdor mbrojtësen e kokës, të bërrylave ose të gjunjëve para së të hipë në një | rreziqet nga të gjitha drejtimet.<br>➦ Ndjek rregullat se si të sillet në rrugë, në transportin publik apo në vende të tjera publike, në mënyrë që të shmangen aksidentet dhe situatat e rrezikshme.<br>➦ Tregon se ku, kur dhe kujt mund t'i kërkojë ndihmë.<br>➦ Dallon rreziqet që vijnë nga lodra apo objekte që mund ta dëmtojnë dhe shmanget prej tyre.<br>➦ Nëse përdor shami hundësh (letre) e hedh në vendin e përshtatshëm.<br>➦ Është në gjendje të kërkojë ndihmë, në rast se ndodhet në rrezik ose në një situatë të vështirë.<br>➦ Parashikon dhe kupton pasojat e moszbatimit të rregullave. |

| | | |
|---|---|---|
| | lodër apo makinë që ecën shpejt. | |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 6**

- Përgatitja e etiketave me simbolet e mbrojtjes dhe të kujdesit ndaj rreziqeve.
- Përgatitja e shenjave dhe simboleve me rregulalt kryesore të sigurisë.
- Veçimi i lodrave dhe i objekteve të rrezikshme për jetën e njeriut.
- Improvizimi i një kryqëzimi ku zbatohen rregullat e ecjes në vijat e bardha.
- Improvizime situatash me sjellje e veprime të gabuara të fëmijëve në mjediset e brendshme të shtëpisë, në oborin para pallatit, në komunietet, në këndin e lojërave, “Në kryqëzim”, “Vendosja e rripit të sigurisë” në makinë dhe në mjete të tjera udhëtimi.
- Improvizime situatash ku fëmija ndodhet në rrugë, në udhëtim me transport publik apo në vende të tjera publike.
- Improvizime situatash ku fëmija gjen zgjidhje të situatave të vështira.
- Lojëra simbolike në të cilat fëmija këshillon kukullën si të veprojë në situata të caktuara.
- Mbajtja e thikës në mënyrën e duhur.
- Vjershë “Semafori”.
- Tregimi “Kush e shëroi gjyshin?” – shenjat e sëmundjeve të ndryshme”.
- Lojë: “Në ambulancë - Doktori viziton të sëmurin”.
- “Në kryqëzim me semafor”; “Në kryqëzim me xhaxhi policin”.

# FUSHA: ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL

## Përshkrimi i fushës

Zhvillimi social dhe emocional është i rëndësishëm për fëmijën për të nisur një jetë sociale të shëndetshme, për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët dhe për të pasur një ndërveprim pozitiv me bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Krijimi i marrëdhënieve të shëndetshme, zhvillimi emocional dhe menaxhimi i sjelljeve dhe veprimeve të nxituara në situata e kontekste të caktuara janë aftësi që duhen zhvilluar me fëmijët parashkollorë.

**Zhvillimi emocional** dhe **social** përfshin aktivitetet që fokusohen në dhënien e ndihmës për fëmijët në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira shoqërore me miq të rinj dhe të vjetër, të shkojë mirë me të tjerët, të manaxhojë emocionet, të shprehë vetveten, të ketë dëshirë të mësojë gjëra të reja, të fillojë dhe të mbarojë një aktivitet, të marrë përgjegjësi për veprimet dhe sjelljet që kryen. Në këtë kuadër, ka një sërë aftësish sociale dhe emocionale që fëmijët duhet t'i mësojnë apo t'i zhvillojnë gjatë moshës parashkollore si për shembull:

- vetëbesimin;
- aftësinë për të ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhënie me bashkëmoshatarët;
- aftësinë për t'u përqëndruar dhe për të këmbëngulur në përmbushjen e kryerjes së detyrave sfiduese për ta;
- aftësinë për të njohur dhe për t'ua komunikuar të tjerëve emocionet e tyre;
- aftësinë për të dëgjuar udhëzimet e dhëna dhe t'u kushtojnë vemëndje atyre që u thuhet.

Aftësitë e lartpërmendura mund të konsiderohen edhe si themelet e të mësuarit të aftësive sociale dhe emocionale të çdo fëmije.

**Zhvillimi social** dhe **emocional** janë dy fusha të ndryshme të të mësuarit. Zhvillimi social i referohet ndërveprimit të fëmijës me të tjerët si dhe ndërtimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me ta. Zhvillimi emocional i referohet kuptimit të emocioneve që fëmija ndjen, emërtimit të tyre dhe vetërregullimit emocional i cili varet nga ndërveprimi me figuren e kujdesit, ambjenti, por edhe nga

personaliteti e tij/e saj. Duhet pranuar që të dyja këto fusha zhvillimi janë të ndryshme nga njëra-tjetra, por që kombinohen së bashku për shkak të ndikimeve që ato kanë te njëra-tjetra.

Mjediset e fëmijërisë së hershme që u përgjigjen nevojave të zhvillimit emocional të fëmijëve kanë për qëllim që të ndihmojnë fëmijët që të fitojnë aftësitë sociale dhe emocionale të nevojshme për t’i bërë ata aktiv dhe nxënës të suksesshëm. Nëse fëmijëve u mungojnë mundësitë që të zhvillojnë këto aftësi në një mjedis të sigurtë dhe që u përgjigjet (u përmbush) nevojave të tyre sociale dhe emocionale, atëherë këta fëmijë mund të kenë vështirësi në përqëndrim si dhe mund të kenë sjellje të vështira për t’i menaxhuar në një grup të madh fëmijësh.

Karakteristikë e zhvillimit të fëmijës nga mosha 3-6 vjeç është fitimi i shprehive që rrisin vetëndërgjegjësimin dhe vetëkontrollin. Shprehitë sociale dhe zhvillimi emocional (që shfaqet në aftësinë për të treguar vëmendje, për të kaluar nga një veprimtari në tjetrën dhe për të bashkëpunuar me të tjerët) janë pjesë e rëndësishme e edukimit parashkollor.

Në këtë moshë, fëmija i mëson vlerat humane nëpërmjet aktiviteteve dhe marrëdhënieve të përditshme me të tjerët. Ai krijon modele duke parë, duke dëgjuar dhe duke diskutuar me të rriturit. Fëmija ka nevojë të ndihet mirë me veten, të hyjë lehtë në marrëdhënie me të tjerët dhe të fitojë qetësi gjatë zgjidhjes së situatave problemore dhe problemeve me të cilat ndeshet në jetën e përditshme.

Zhvillimi i personalitetit të fëmijës duke respektuar ritmin, nevojat dhe interesat e grupmoshës, zbulimi i vetes, fitimi i pavarësisë dhe zhvillimi i një imazhi pozitiv për veten janë cilësi të lidhura ngushtësisht me fushën e zhvillimit social e personal.

**Nënfushat dhe përshkrimi i tyre**

## 2.1 ZHVILLIMI SOCIAL

### 2.1.1 Ndërveprimi me të rriturit

### 2.1.2 Ndërveprimi me bashkëmoshatarët

### 2.1.3 Përshtatja e sjelljes sociale

## 2.2 ZHVILLIMI EMOCIONAL

### 2.2.1 Koncepti për veten

### 2.2.2 Shprehja dhe menaxhimi i emocioneve

### 2.2.3 Vetëkontrolli

**Zhvillimi social** dhe ndërveprimi me të tjerët ndikojnë te fëmija për mënyrën se si ai sheh veten, të tjerët dhe botën që e rrethon. Nëpërmjet zhvillimit social, fëmija njeh mjedis social e kulturor që e rrethon, vlerëson komunitetin në të cilin jeton dhe kontribuon në mbarëvajtjen e jetës së përbashkët në këtë komunitet.

**Zhvillimi emocional** është i lidhur me aftësinë e fëmijëve për të shfaqur e ndjerë emocione, për t'i shprehur në mënyrën e duhur, për të menaxhuar veten në situata të vështira e për të shmangur në mënyrën e duhur reagimet negative. Pjesë e zhvillimit emocional janë edhe përpjekjet e fëmijës për të njohur veten, aftësitë që zotëron e për të bërë vlerësime pozitive.

Për secilën nënfushë janë përcaktuar standardet dhe treguesit, të cilët kanë për qëllim që fëmija të zhvillojë aftësitë për të kontrolluar sjelljen dhe veprimet, të ndërtojë marrëdhënie pozitive me të tjerët, të rrisin besimin në vete, të vlerësojnë aftësitë që zotërojnë.

## 2.3 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE

| | | |
|---|---|---|
| **II.1 Zhvillimi social** | **II.1.1 Ndërveprimi me të rriturit** | **Standardi 1.** Fëmija ndërvepron lehtësisht me të rriturit që njeh.<br>**Standardi 2.** Fëmija kërkon ndihmë nga i rrituri kur ka nevojë.<br>**Standardi 3.** Fëmija dallon personat e njohur nga personat e panjohur. |
| | **II.1.2 Ndërveprimi me bashkëmoshatarët** | **Standardi 4.** Fëmija krijon marrëdhënie shoqërore dhe bashkëpunon me bashkëmoshatarët. |
| | **II.1.3 Përshtatja e sjelljes sociale** | **Standardi 5.** Fëmija kupton sjellje të ndryshme dhe ndikimin e tyre (pozitiv dhe negativ).<br>**Standardi 6.** Fëmija merr përgjegjësi, negocion dhe merr pjesë në marrjen e vendimeve.<br>**Standardi 7.** Fëmija përshtatet në mjedise të ndryshme.<br>**Standardi 8.** Fëmija shfaq empati përkundrejt të tjerëve. |
| **II.2 Zhvillimi emocional** | **II.2.1 Koncepti për veten** | **Standardi 9.** Fëmija mban dhe zhvillon qëndrim pozitiv për veten, kupton se është unik dhe ndihet krenar për arritjet e tij/e saj. |
| | **II.2.2 Shprehja dhe menaxhimi i emocioneve** | **Standardi 10.** Fëmija shpreh dhe menaxhon në mënyrën e duhur sjelljen dhe emocionet. |
| | **II.2.3 Vetëkontrolli** | **Standardi 11.** Fëmija shfaq aftësi vetëkontrolli në punë individuale dhe në grup. |

## 2.4 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE

**Standardi 1: Fëmija ndërvepron lehtësisht me të rriturit që njeh.**

**Treguesit për Standardin 1**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Njeh emrat e motrave dhe vëllezërve.<br>➦ Shpreh dashuri dhe ndjenja pozitive përkundrejt të rriturve të njohur.<br>➦ Ndahet nga të rriturit që njeh pa treguar ankth të madh, por nuk qëndron larg tyre për një kohë të gjatë. | ➦ Ndihmon të rriturit në kryerjen e detyrave të vogla.<br>➦ Ndihet mirë kur bën gjëra për të kënaqur të rriturit (këndon, kërcen, reciton një vjershë). | ➦ Ndërvepron me të rriturit në komunitet (komshinjtë, mësuesin, punonjës të komunitetit etj.).<br>➦ Ndahet lehtësisht nga familjarët kur shkon në kopsht.<br>➦ Shfaq mirësjellje kur bashkëvepron me të rriturit.<br>➦ Përshëndet në rrugë të afërmit dhe njerëzit që njeh. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë praktike për përmbushjen e treguesve të standardit 1**

- Improvizime situatash në dyqane ku shiten artikuj të ndryshëm me qëllim përdorimin e fjalëve magjike.
- Improvizime situatash nga jeta e përditshme familjare.
- Shfletimi i albumit të fotografive të pjesëtarëve të familjes.
- Lojë simbolike “Në familje” për marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të familjes.
- Lojë simbolike “Ardhja dhe largimi nga kopshti”

- Loja “Rrëmbimi i shamisë”
- Loja me stafeta
- Lojë simbolike “Në shtëpi ndihmojnë të gjithë” për kontyributin që jep çdo pjesëtar në familje.
- Lojë në role “Në dyqan” për marrëdhëniet shitës –blerës.

**Standardi 2: Fëmija kërkon ndihmë nga të rriturit kur ka nevojë.**

**Treguesit për Standardin 2**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bën pyetje të shpeshta tek të rriturit e afërm për të marrë informacion.<br>➦ Kërkon ndihmë dhe mbështetje emocionale kur ka nevojë.<br>➦ Tërheq vëmendjen e të rriturve për situata të thjeshta problematike që janë duke ndodhur (vëllai po qan, motra nuk ma jep telekomandën etj). | ➦ Ndjek udhëzimet dhe u bindet me besim prindërve, të afërmve, mësuesit dhe njerëzve të tjerë të njohur.<br>➦ Ndjek udhëzimet e të rriturit në lidhje me mënyrën e sjelljes në mjedise të ndryshme.<br>➦ Kërkon mendimin e të rriturit dhe udhëheqjen e tyre për aktivitete të ndryshme. | ➦ Kërkon ndihmë nga të rriturit, si fqinj, të afërm, shokë etj.<br>➦ Bën pyetje para se të thyejë rregulla apo rutina të përditshme.<br>➦ Kupton dhe parashikon pasojat që vijnë nga lojëra dhe mjetet e rrezikshme, si: piruni, thika, shtiza, sende me maja të mprehta etj.<br>➦ Pranon vendimet e të rriturve. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 2**

- Improvizime situatash në mjedise të ndryshme, në të cilat fëmija merr dhe ofron ndihmë.

- Improvizime situatash nga jeta e përditshme familjare me tema të tilla si: “Vëllai sëmurë”, “Kukulla në rrezik”, ku fëmijët orientohen ku dhe si të kërkojnë ndihmë në rast nevoje.
- Lojë simbolike “Në teatrin e kukullave”, “Në cirk” ose “Në kinema”, ku fëmijët mësojnë si të sillen në vende të tilla
- Lojë simbolike “Alo ambulanca”.

**Standardi 3: Fëmija dallon personat e njohur nga personat e panjohur**.

**Treguesit për Standardin 3**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ I ofron ndihmë një personi të njohur gjatë lojës ose veprimtarisë që po kryen.<br>➦ Rezervohet nga personat e panjohur. | ➦ Në fotografi ose në filmime të ndryshme dallon njerëzit e njohur.<br>➦ Jep të dhëna për personat e njohur.<br>➦ Shfaq dëshirë e interes për të njohur njerëzit që vijnë në familjen e vet. | ➦ Flet lirshëm me personat e njohur për ngjarje që i kanë ndodhur.<br>➦ Bën pyetje për njerëz që i sheh për herë të parë në rrethin e vet familjar. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 3**

- Improvizime të situatave të ndryshme ku njerëz të panjohur u ofrojnë fmëijëve dhurata, para, karamele etj. dhe mënyrat për t’i shmangur ato.
- Veshim - zhveshim kukullat me qëllim ndihmën që i japim njëri-tjetrit.
- Komentime të regjistrimeve të bëra në ceremoni dhe festa familjare dhe shoqërore.
- Punimi i përrallave të njohura si “Kësulëkuqja”, “Borëbardha” për të kuptuar rëndësinë e shmangies së njerëzve të panjohur.
- Lojë simbolike “Kukulla në shtëpinë time” ku improvizohen situata të takimit me njerëz të panjohur.

- Loja “Macja kapi miun”
- Lojë simbolike “Në fundjavë me kukullën/arushin”, me qëllim që fëmijët të nxiten për të përshkruar veprimtaritë që kanë kryer.

**Standardi 4: Fëmija krijon marrëdhënie shoqërore dhe bashkëpunon me bashkëmoshatarët.**

**Treguesit për Standardin 4**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Tregon kënaqësi kur është duke luajtur me fëmijë të tjerë.<br>➦ Zgjedh lojën që i pëlqen.<br>➦ Ndahet nga të rriturit për të luajtur me shokët dhe shoqet.<br>➦ Bën dhe mban miqësi me të paktën me një fëmijë tjetër.<br>➦ Përfshihet në aktivitete me më shumë se një fëmijë. | ➦ Bashkëpunon me fëmijët e tjerë, ndonjëherë me ndihmën e të rriturve.<br>➦ Ndan materiale dhe lodra me shokët.<br>➦ Ndahet më dëshirë nga të rriturit për të luajtur me shokët dhe shoqet në pjesën me të madhe të herëve.<br>➦ Ndjek vendimet e grupit.<br>➦ Merr vendime duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët. | ➦ Zhvillon miqësi me shumë shokë dhe shoqe.<br>➦ Tregon besnikëri e mbështet shokët.<br>➦ Zë shokë dhe shoqe në mjedise të ndryshme (p.sh: në komunitet, në kopsht, në këndin e lojërave etj.).<br>➦ Propozon dhe ndjek udhëzimet e një fëmije tjetër.<br>➦ Negocion me fëmijët e tjerë për të zgjidhur një problem.<br>➦ Kërkon dhe jep ndihmë kur është e nevojshme. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 4**

- Shembuj dhe raste nga veprimtaria e përditshme në kopsht, në të cilat fëmijët analizojnë veprimet dhe sjelljet e tyre ndaj shokëve/shoqeve.
- Lojë simbolike me kukulla për të improvizuar hyrjen në biseda të fëmijëve me njëri-tjetrin, marrëdhëniet në lojë, zgjidhjen e situatave të ndryshme etj.
- Lojë në role “Te këndi i lojërave”, “Në ditëlindjen e shokut/e shoqes” për të improvizuar marrëdhëniet me njëri-tjetrin.
- Vizitë te dentisti.

**Standardi 5: Fëmija kupton sjellje të ndryshme dhe ndikimin e tyre (pozitiv dhe negativ).**

**Treguesit për Standardin 5**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Ndjek rregulla të thjeshta edhe pse në pjesën më të madhe të kohës duhet rikujtuar.<br>➦ Pret radhën e tij/e saj gjatë lojës. | ➦ Luan ose punon pa shqetësuar të tjerët.<br>➦ Bashkëpunon me bashkëmoshatarët për të përmbyllur një aktivitet. | ➦ Parashikon ndikimin që do të ketë sjellja e tij/e saj te të tjerët.<br>➦ Di dhe përshkruan si ndihen të tjerët nëse shfaq një sjellje të caktuar. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 5**

- Improvizime të veprimeve rutinë që bëhen në mëngjes dhe në darkë.
- Improvizimi i situatave ku fëmijët hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe analizojnë sjelljen dhe veprimet në to.
- Improvizime situatash ku fëmijët dallojnë raste ku veprojnë gabim ose shkelin rregullat në mjedise të ndryshme.
- Punimi i tregimeve me temë nga jeta e përditshme e fëmijëve, zbatimi i regjimit ditor etj.
- Lojë në role “Porsa ngrihem në mëngjes”, “Në familje dhe në kopsht kryej detyra të caktuara”
- Punimi i tregimeve me temë nga jeta e përditshme e fëmijëve dhe ngjarje që lënë gjurmë në kujtesën e çdo fëmije.

**Standardi 6: Fëmija merr përgjegjësi, negocion dhe merr pjesë në marrjen e vendimeve.**

**Treguesit për Standardin 6**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Përdor strategji të thjeshta për të zgjidhur problemet individuale ose të grupit (psh.: kërkon ndihmë nga një i rritur).<br>➦ Merr vendime të thjeshta në lidhje me përgjegjësitë që i ngarkohen (p.sh: për ushqimin, lodrat, rrobat) | ➦ Merr pjesë në marrjen e vendimeve me mbështetjen e të rriturve.<br>➦ Përdor strategji të ndryshme për t'u bërë pjesë e lojës.<br>➦ I bën të qarta të drejtat e veta.<br>➦ Jep arsye për zgjidhjen e një konflikti.<br>➦ Identifikon veten si anëtar i një grupi.<br>➦ Në një lojë simbolike, e zgjedh vetë rolin që do të luajë. | ➦ Ndjek i pavarur procedurat e rutinës së përditshme në shtëpi ose në klasë.<br>➦ Merr në konsideratë dëshirat dhe nevojat e fëmijëve të tjerë.<br>➦ Është i aftë që të kërkojë të drejtat e veta.<br>➦ Shmang situatat që çojnë në konflikt.<br>➦ Përpiqet të rregullojë pasojat e sjelljes së gabuar që ka demonstruar. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 6**

- Improvizime situatash ku fëmijët udhëtojnë me mjete të ndryshme.
- Improvizime të situatave në të cilat trajtohen raste të zbatimit dhe të shkeljes së të drejtave të fëmijëve.
- Improvizime të situatave në të cilat trajtohen raste të zbatimit ose jo të procedurave rutinë, të të drejtave të lojës me role "Qyteti ynë ka nevojë për ndihmën tonë"
- Lojë në role "Kemi një problem që ka nevojë për t'u zgjidhur nga ne fëmijët".
- Lojë në role "Mëngjesi i një familjeje".

**Standardi 7: Fëmija përshtatet në mjedise të ndryshme.**

**Treguesit për Standardin 7**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bën kalim të butë nga një aktivitet në tjetrin gjatë ditës.<br>➦ Kupton se mund të ndryshojë mjedisin disa herë gjatë ditës dhe që shpesh këto ndryshime mund të jenë të vështira.<br>➦ Eksploron lodrat dhe materialet duke ndërvepruar me të tjerët në mjedise të ndryshme. | ➦ Përshtat sjelljen në mjedise të ndryshme (si p.sh: në shtëpi, në kopsht, në këndin e lodrave etj.)<br>➦ Kupton që në mjedise të ndryshme shfaqin sjellje të ndryshme (p.sh: flasim me zë ulët në një bibliotekë). | ➦ Parashikon ngjarjet që mund të ndodhin në mjedise të ndryshme.<br>➦ Përshtatet në mjediset dhe në aktivitetet e ndryshme që zhvillohen gjatë ditës. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 7**

- Improvizime situatash në të cilat fëmijët kalojnë nga njëra veprimtari në tjetrën sipas komandave, sinjaleve dhe shenjave që u jepen.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët ndodhen në mjedise të ndryshme, si: “Në teatër mbajmë qetësi”, “Në këndin e lojërave kënaqemi të gjithë”, “Në dyqan mbajmë radhën”, “ShShShT! Kukulla po fle” etj.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët zbatojnë procedurat dhe veprimet ditore rutinë.

**Standardi 8: Fëmija tregon empati përkundrejt të tjerëve.**

**Treguesit për Standardin 8**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Dallon gjendjet emocionale të fëmijëve të tjerë.<br>➦ Përfshihet në gjendjen emocionale të fëmijëve të tjerë. | ➦ Shpreh ndjenjat dhe emocionet nëpërmjet personazheve të përrallave, tregimeve, filmave.<br>➦ Sillet me mirësi dhe butësi ndaj kafshëve dhe bimëve.<br>➦ Mbështet bashkëmoshatarët kur vriten ose janë të shqetësuar. | ➦ Flet për emocionet e njerëzve të tjerë.<br>➦ Mbështet familjarët ose miqtë që nuk ndjehen mirë.<br>➦ Shpreh emocionet e duhura kur shikon kafshë të ngordhura (zog, peshk, kavie, breshkë etj.) ose kur sheh një njeri që është i mërzitur. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 8**

- Kartela me figura, filma dhe veprimtari në të cilat fëmijët shfaqin gjendje të ndryshme emocionale.
- Improvizime situatash ku fëmijët shprehin emocione, tregojnë kujdes dhe mbajnë qëndrime të caktuara.
- Organizme të veprimtarive të tilla, si: gara me biçikleta, ngritje balonash etj.
- Përralla të cilat kanë në fokus empatinë, si mund t’i ndihmojmë të tjerët ose si mund t’i ngushëllojmë miqtë.

**Standardi 9. Fëmija mban dhe zhvillon qëndrim pozitiv për veten, kupton se është unik e ndihet krenar për arritjet e tij/e saj.**

**Treguesit për standardin 9**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Dallon gjininë e vet.<br>➦ Dallon gjërat e veta personale dhe tregon kujdes të vazhdueshëm për to (lodra, veshje, sende të ndryshme).<br>➦ E përfshin veten në role të ndryshme | ➦ Përshkruan karakteristikat individuale.<br>➦ Ndan me të tjerët informacion rreth vetes dhe familjes.<br>➦ Kryen me besim i pavarur veprime | ➦ Përshkruan veten duke iu referuar cilësive fizike, preferencave, mendimeve, ndjenjave dhe mënyrës së sjelljes.<br>➦ Tregon për rolin dhe vendin që zë në familje krahasuar me pjesëtarët e tjerë të |

| | | |
|---|---|---|
| gjatë lojërave simbolike (zgjedh ato role që pëlqen).<br>➦ Shfaq besim pozitiv për veten (kur bën një vizatim, kur përfundon një detyrë, kur reciton një vjershë etj).<br>➦ Bën zgjedhje ndërmjet alternativave që i ofrohen.<br>➦ Kujdeset për gjërat e veta.<br>➦ Di dhe shpreh çfarë i pëlqen ose jo, për çfarë ndjehet mirë dhe për çfarë jo.<br>➦ Dallon te vetja 2-3 cilësi pozitive.<br>➦ Mezi pret t'u tregojë të tjerëve një punim për të cilin është lavdëruar më parë.<br>➦ Shprehet i kënaqur kur arrin të bëjë diçka për të cilën nuk kishte besim se do t'ia dilte mbanë.<br>➦ Provon përvoja të reja në mjedisin ku ndodhet. | të ndryshme.<br>➦ Provon me guxim dhe besim përvoja të reja.<br>➦ Përmbush detyra të njohura më parë për të (P.sh: pas lojës vendos lodrat në vendin e duhur).<br>➦ Ndjek rregullat dhe procedurat rrutinë dhe përshtatet lehtë me rregulla dhe procedura të reja.<br>➦ Prezanton te bashkëmoshatarët ose të rritur një punë të përfunduar.<br>➦ Shpreh vetëvlerësim për një punë që thotë se e ka bërë mirë. | saj.<br>➦ Tregon kombësinë që i përket, gjuhën që flet dhe elemente të tjera të identitetit kombëtar e kulturor.<br>➦ Pyet fëmijët e tjerë rreth familjes, kombësisë, kulturës dhe i dëgjon me vëmendje kur ata përgjigjen.<br>➦ Tregon se në cilin drejtim/ veprimtari/ sport e ndien veten mirë.<br>➦ I afrohet një grupi dhe bëhet pjesë e tij pasi vëzhgon dhe kupton çfarë po bëjnë.<br>➦ Merr përgjegjësi dhe këmbëngul për ta çuar një detyrë deri në fund.<br>➦ Shfaq mendimin e tij/e saj në biseda që zhvillon me të tjerët.<br>➦ U referohet ndjenjave dhe mendimeve të të tjerëve kur interpreton sjelljen e tyre.<br>➦ Kryen i pavarur një punë dhe shfaq kënaqësi gjatë kryerjes së saj.<br>➦ Beson se është i zoti të marrë vetë vendime, të përfundojë një detyrë pa ndihmën e të tjerëve apo të arrijë një qëllim që i ka vënë vetes. |

| | | |
|---|---|---|
| | | ➦ Krenohet për arritjet e veta dhe ka besim në aftësitë individuale.<br>➦ Shfaq përkushtim për një seri aktivitetesh. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 9**

- Improvizim situatash ku fëmijët reflektojnë ndaj arritjeve të tyre, ndaj punëve dhe detyrave që kryejnë, të sjelljeve dhe veprimeve që kryejnë etj.
- Improvizime bisedash dhe situatash në të cilat fëmijët u tregojnë kukullave për gjërat që dinë të bëjnë më mirë.
- Veprimtari praktike "Kujdesi gjatë lojës", "Sistemimi i lodrave", "Jap ndihmën time" etj.
- Lojë simbolike "Në shtëpi me prindërit".

**Standardi 10. Fëmija përjeton, shpreh dhe menaxhon në mënyrën e duhur sjelljen dhe emocionet.**

**Treguesit për standardin 10**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Emërton emocionet kryesore (i gëzuar, i mërzitur, i lumtur).<br>➦ Shpreh emocionet me fjalë, mimikë dhe veprime të ndryshme trupore.<br>➦ Shfaq kënaqësi kur përfundon një punë.<br>➦ Shfaq kënaqësi kur arrin të qetësojë një shok. | ➦ Përshkruan saktë dhe me detaje gjendjen emocionale në të cilën ndodhet duke dhënë edhe arsyet përkatëse.<br>➦ Ndan emocionet e veta me të tjerët.<br>➦ Ndjen dhe shpreh dhembshuri ndaj të tjerëve (bashkëmoshatarë apo të | ➦ I lidh emocionet me ngjarjet e zhvilluara apo me ato që do të përjetojë së shpejti.<br>➦ Kontrollon në masë të konsiderueshme emocionet që përjeton.<br>➦ Shpreh emocionet nëpërmjet artit dhe lojës.<br>➦ Jep arsye për emocionet që përjeton. |

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Shpreh në mënyra të ndryshme kënaqësinë që fiton kur merr një dhuratë.<br>➦ Tregon ndjeshmëri ndaj bashkëmoshatarëve kur ata përjetojnë emocione të ndryshme.<br>➦ Kontrollon të qarët dhe të bërtiturit në vende publike.<br>➦ Bën zgjedhje ndërmjet 2-3 zgjidhjeve/ opsioneve që i ofrohen.<br>➦ Nëse sheh në një fotografi një fëmijë që qesh/ qan bën pyetje për të marrë vesh arsyen.<br>➦ Pasi përjeton një situatë të fortë emocionale përpiqet të qetësohet me ndihmën e të rriturit. | rritur qofshin).<br>➦ Tregon durim deri në momentin që merr shpërblimin apo vlerësimin e një pune të kryer.<br>➦ Menaxhon rastet kur nuk merr vlerësimin e dëshiruar për punën që ka bërë.<br>➦ Shpreh ndjenjat kryesore, nevojat dhe dëshirat sipas situatës në të cilën ndodhet.<br>➦ Shpesh i duhet ndërhyrja e të rriturit për të menaxhuar sjelljet impulsive.<br>➦ Përshkruan gjendjen emocionale dhe e mban nën kontroll me ndihmën e të rriturit.<br>➦ Krenohet për një punë të kryer vetëm apo me të tjerë. | ➦ Ndan me të tjerët (bashkëmoshatarët dhe familjarët) ndjenjat dhe emocionet.<br>➦ Qetëson emocionet negative ose impulset e çastit, duke bërë diçka tjetër në vend të shprehjes së tyre (kur orientohet nga i rrituri).<br>➦ Përshkruan gjendjen në të cilën ndodhet.<br>➦ Kërkon t'i zgjidhë konfliktet në mënyrë paqësore.<br>➦ Diferencon sjelljen sipas situatave dhe konteksteve të caktuara.<br>➦ Pranon mërzinë në rastet kur gjendet në një situatë të vështirë apo një ngjarje të rëndë. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 10**

- Improvizime situatash në të cilat fëmijët përjetojnë emocione të ndryshme.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët përjetojnë emocione të ndryshme, të lindura në kontekste të caktuara.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët zgjidhin situata konfliktuale të lindura gjatë lojës/ veprimtarisë.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët imagjinojnë se si do të silleshin në kontekste të caktuara.

- Lojë e pasqyrës, para të cilës fëmijët komunikojnë me gjuhën e trupit dhe të fytyrës.

**Standardi 11. Fëmija shfaq aftësi vetëkontrolli në punë individuale dhe në grup**

**Treguesit për Standardin 11**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Zgjedh veprimtarinë me të cilën i pëlqen të merret.<br>➦ Bashkohet me fëmijët e tjerë për aktivitetet që e tërheqin.<br>➦ Ndodh që kundërshton të marrë pjesë në aktivitetet e sugjeruara nga i rrituri.<br>➦ Respekton rregullat e thjeshta të grupit.<br>➦ Ndërpret një veprimtari apo lojë kur i kërkohet.<br>➦ Ndjek rregullat dhe procedurat rutinë pa qenë e nevojshme për t'ia kujtuar të gjitha.<br>➦ Bashkëpunon dhe nis ta përqendrojë vëmendjen në udhëzimet apo sqarimet që bën i rrituri.<br>➦ Me ndihmën e të rriturit dhe nën vëmendjen e tij pret për një periudhë | ➦ Kryen veprime të ndryshme në mënyrë të pavarur.<br>➦ Përmbush me sukses detyra të njohura më parë për të (p.sh: pas lojës vendos lodrat në vendin e duhur).<br>➦ Ndjek rregullat në një lojë/ veprimtari të drejtuar nga një bashkëmoshatar ose i rritur.<br>➦ Ndjek rregullat dhe procedurat rutinë dhe përshtatet lehtë me rregulla dhe procedura të reja.<br>➦ Zbaton rregullat dhe procedurat rutinë pa kundërshtuar.<br>➦ Kërkon leje për të përdorur lodrën apo mjetin me të cilin luan/ punon shoku.<br>➦ Pret radhën për të bërë diçka që i | ➦ Kryen i pavarur procedurat e rutinës së përditshme.<br>➦ Përshtatet me lehtësi ndaj rregullave të reja, pasi e kupton se çfarë i kërkohet.<br>➦ Frenohet në shfaqjen e reagimeve negative. |

| | | |
|---|---|---|
| të shkurtër kohe të marrë atë që do (lodrën nga shoku, topin nga shoqja etj. | pëlqen, kur ndodhet në këndin e lojërave.<br>➦ Tregon durim deri në momentin që merr shpërblimin apo vlerësimin e një pune të kryer. | |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 11**

- Improvizime situatash në të cilat fëmijët vihen para zgjedhjesh të ndryshme.
- Improvizime situatash në të cilat fëmijët zihen për një lodër a për një veprimtari dhe nxjerrin mësime si të zgjidhin situatat konfliktuale në rastet e sipërpërmenduara.
- Përralla e tregime nga të cilat fëmijët nxjerrin mësime si të zgjidhin situatat konfliktuale në lojë dhe në veprimtari të ndryshme.
- Loja me stafeta, për fitimin e së cilës fëmijët duhet të bashkëpunojnë me shokët e skuadrës.

# FUSHA: ZHVILLIMI NJOHËS DHE NJOHURI TË PËRGJITHSHME

## Përshkrimi i fushës

**Zhvillimi njohës** ka të bëjë me aftësitë, proceset dhe strategjitë që fëmijët përdorin për të eksploruar dhe mësuar rreth botës si dhe për të mësuar për të zgjidhur problemet dhe sfidat.

Zhvillimi njohës përfshin një proces në të cilin fëmijët e vegjël rriten dhe ndryshojnë në aftësinë e tyre për t'u përqendruar dhe për të menduar për botën rreth tyre. Komponentët në këtë fushë përfshijnë logjikën dhe arsyetimin, kujtesën, vëmendjen dhe kontrollin, si dhe fleksibilitetin njohës.

Gjatë 5 viteve të para, fëmijët demonstrojnë rritje të shpejtë në fushën njohëse dhe njohuritë e përgjithshme. Lidhja në këto vite mes përvojave pozitive dhe zhvillimit njohës mbështetet nga të dhënat më të fundit shkencore mbi funksionimin e trurit. Studimet tregojnë se mjediset stimuluese dhe mbështetëse janë thelbësore për zhvillimin optimal në këtë fushë.

### Nënfushat dhe përshkrimi i tyre

## 3.1 Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve

## 3.2 Zhvillimi matematikor

## 3.3 Zhvillimi Shkencor

## 3.4 Njohja sociale

## 3.5 Zhvillimi Artistik

**Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve.** Përfshin aftësitë e fëmijës për të analizuar informacionet/njohuritë dhe situatat me qëllim krijimin e gjykimeve të përshtatshme, si dhe për të eksploruar një sërë alternativa zgjidhjeje ndaj një pyetjeje, detyre apo problemi të caktuar.

**Zhvillimi matematikor.** Kjo nënfushë përfshin aftësi matematikore të cilat zhvillohen duke lidhur njohuritë me përvojat e të mësuarit si për shembull: klasifikimi, grupimi, renditja, kategorizimi, matja dhe përafrimi i karakteristikave të objekteve, qënieve të gjalla, fenomeneve dhe ngjarjeve. Të gjitha këto aftësi duan mbështetje konkrete (materiale, objekte), vëmendje dhe mbështetjeje të vazhduar nga të rriturit që fëmijët të mund të eksplorojnë dhe të kuptojnë konceptet matematikore.

**Zhvillimi shkencor.** Fëmijët e vegjël marrin njohuri shkencore duke përdorur shqisat e tyre për të bashkëvepruar me mjedisin dhe për të pasur një kuptim mbi botën që i rrethon. Kuptimi i tyre mbi shkencën zgjerohet dhe mbështetet nga të rriturit, njohuritë dhe dijet e të cilëve përmbushin kuriozitetin e fëmijëve. Fëmijët janë më të prirur për të vëzhguar, për të pyetur, si dhe për të reflektuar ndaj hulumtimeve dhe "zbulimeve" që kanë bërë, kur në këto procese ata nxiten dhe udhëhiqen nga mësuesit. Kështu, gjatë gjitha viteve të edukimit parashkollor, fëmijët motivohen të zhvillojnë dhe të përsosin njohuritë e tyre shkencore nëpërmjet vëzhgimit herë të lirë dhe herë të qëllimshëm, drejtimit të pyetjeve për të shuar kuriozitetin e për të njohur botën që i rrethon, eksperimentimeve me

materiale dhe objekte të  ndryshme, nëpërmjet të cilave pajisen me njohje dhe mundësi të reja për  zbulime dhe hulumtime më të përqendruara.

**Njohja sociale**. Fëmijët e vegjël arrijnë të dallojnë të përbashkëtat dhe ndryshimet midis vetes dhe të tjerëve. Kontakti i parë që ata kanë janë anëtarët e familjes. Ata përqendrohen në karakteristikat fizike dhe në zakonet e familjes. Socializimi i tyre në familje realizohet kur ata hyjnë në marrëdhënie me anëtarët e familjes dhe fillojnë të mësojnë rolet në familje. Përballja e tyre me fëmijët e tjerë i bën ata të kuptojnë se struktura e familjes së shokëve është e ndryshme, kjo gjë që i shtyn ata  të eksplorojnë këto dallime.
Interesi i fëmijëve është shumë i madh për pjesëtarët e komunitetit ku ata jetojnë. Ata fillojnë të njohin rolet dhe profesionin e anëtarëve të komunitetit dhe nëpërmjet lojës me role luajnë mjekun, infermierin, shitësin etj.

**Zhvillimi artistik.** Kjo nënfushë  trajton aftësitë e fëmijëve për të imagjinuar dhe fantazuar, për të komunikuar dhe shprehur ndjenjat, idetë, vëzhgimet dhe përvojat në mënyrë krijuese.

## 3.6 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE

| | |
|---|---|
| **III.1 Të menduarit logjik dhe zgjidhja e problemeve** | **Standardi 1:** Fëmija zbulon lidhjet mes shkakut dhe pasojës.<br>**Standardi 2:** Fëmija vëzhgon, krahason dhe vlerëson ngjarje dhe veprime.<br>**Standardi 3**: Fëmija kërkon zgjidhje të shumëfishta për detyrat dhe problemet.<br>**Standardi 4:** Fëmija përdor simbole për të paraqitur objekte. |
| **III.2 Zhvillimi matematikor** | **Standardi 5:** Fëmija shfaq interes për numrat dhe numërimin**.**<br>**Standardi 6:** Fëmija identifikon dhe emërton format**.**<br>**Standardi 7**: Fëmija rendit, grupon, klasifikon dhe i organizon objektet duke u nisur nga |

| | |
|---|---|
| | madhësia, pesha, lartësia, gjatësia dhe vëllimi. |
| **III.3 Zhvillimi shkencor** | **Standardi 8:** Fëmija mbledh informacione për mjedisin dhe botën që e rrethon nëpërmjet vëzhgimit dhe hulumtimit, duke përdorur instrumente dhe metoda të ndryshme.<br><br>**Standardi 9**: Fëmija përfshihet në procesin eksplorimit shkencor, bën dhe teston hipoteza të thjeshta, nxjerr konkluzione, bën parashikime.<br><br>**Standardi 10**: Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës së gjallë.<br><br>**Standardi 11:** Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë. |
| **III.4 Njohja sociale** | **Standardi 12**: Fëmija dallon nëse një ngjarje ka ndodhur në të kaluarën, po ndodh tani apo mund të ndodhë në të ardhmen.<br><br>**Standardi 13:** Fëmija demonstron njohuri për vendndodhjen, për marrëdhëniet midis njerëzve, vendeve dhe rajoneve.<br><br>**Standardi 14:** Fëmija kupton se marrëdhëniet midis njerëzve janë në funksion të shkëmbimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.<br><br>**Standardi 15:** Fëmija përdor në mënyrë të përshtatshme disa pajisje teknologjike dhe tregon ndikimin e tyre në jetën e përditshme.<br><br>**Standardi 16:** Fëmija kupton strukturën e familjes, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj.<br><br>**Standardi 17**: Fëmija demonstron njohuri për komunitetin, ndërvarësinë midis njerëzve, rolet e ndryshme sociale dhe përgjegjësinë qytetare<br><br>**Standardi 18:** Fëmija dallon ndryshimet kulturore ndërmjet njerëzve dhe i pranon ato. |
| **III.5 Zhvillimi artistik** | **Standardi 19:** Fëmija përdor artin për të shprehur atë çfarë di, mendon, beson dhe ndjen. |

| | |
|---|---|
| | **Standardi 20:** Fëmija zhvillon njohuri dhe aftësi vlerësuese për artin. |

## 3.7 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE

**Standardi 1: Fëmija zbulon lidhjet mes shkakut dhe pasojës.**

**Treguesit për standardin 1**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Vëzhgon veprimet e të tjerëve për të kuptuar pasojat e tyre mbi objektet.<br>➦ Mbledh informacion për të nxjerrë një konkluzion (p.sh: fëmija vë re se shoku i tij nuk është në klasë: Eri mungon. Ai ndoshta është i sëmurë).<br>➦ Kupton efektin që mund të kenë mbi objekte/ situata të ndryshme veprime të thjeshta (p.sh: nëse bie shi toka laget; nëse hedh kripë në një gotë me ujë, kripa tretet; është qetësi sepse ti e mbylle TV; u bë errësirë sepse iku dielli etj.). | ➦ Përdor pyetjen “Pse?” në përpjekje për të kuptuar shkakun përse gjërat ndodhin (p.sh: nëse unë e bëj këtë, pse ndodh kjo?)<br>➦ Parashikon pasojat që një veprim mund të ketë mbi një objekt (p.sh: do të bëhet errësirë nëse fiket drita).<br>➦ Parashikon se si gjërat mund të ndryshojnë, nëse situatat/ rrethanat ndryshojnë (p.sh: nëse është kohë me re, mund të fillojë shiu).<br>➦ Identifikon objektet që ndikojnë mbi objektet e tjera (p.sh: nga kombinimi i ngjyrës së kuqe me ngjyrën e verdhë, krijohet një ngjyrë e re, ngjyra | ➦ Dallon përmes eksperimenteve se si ndryshimet në një element mund të sjellin ndryshime edhe në elementet e tjera (p.sh: në një gotë me ujë hedh sheqer dhe tregon se uji u ëmbëlsua pasi në të u hodh sheqeri).<br>➦ Identifikon elementet e objekteve që shkaktojnë një efekt/ pasojë të caktuar (p.sh: ka zara brenda në kuti, prandaj bëhet zhurmë). |

| | | |
|---|---|---|
| | portokalli; uji kur futet në frigorifer në ngrirje, shndërrohet në akull). | |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 1**

- Eksperimente me përzierje lëndësh të ndryshme.
- Eksperimente për avullimin dhe ngrirjen e ujit.
- Eksperimente me punimin e materialeve të ndryshme, si plastelinë, argjilë, miell etj.
- Vëzhgime të dukurive të ndryshme natyrore dhe parashikime të mundshme mbi to.
- Lojë me plastelinë, bashkimi i ngjyrave të ndryshme krijon ngjyra të tjera.

**Standardi 2: Fëmija vëzhgon, krahason dhe vlerëson ngjarje dhe veprime.**

**Treguesit për standardin 2**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Kupton konceptet “i ngjashëm”, “ i ndryshëm”.<br>➦ Kupton dhe përshkruan se kur 2 objekte janë të ngjashme apo të ndryshme (p.sh: njëri prej topave është më i madh; fustani im është më i shkurtër se sa i Anës).<br>➦ Përdor veprimet/ fjalët për të justifikuar zgjedhjen e bërë ndërmjet | ➦ Krahason me ndihmën e një të rrituri eksperiencat e kaluara me fëmijë të ndryshëm (p.sh: krahasojnë lojëra të ndryshme që kanë bërë me fëmijë të ndryshëm).<br>➦ Kupton aspektet pozitive dhe negative që sjell një veprim i caktuar me ndihmën e një të rrituri.<br>➦ Përdor shprehjet e duhura krahasuese | ➦ Identifikon cilësi të ndryshme mbi të cilat mund të bëhen krahasimet ndërmjet objekteve (p.sh: sipas madhësisë, ngjyrës, formës).<br>➦ Krahason personazhe apo ngjarje të ndryshme të cilat janë pjesë e tregimeve/ përrallave.<br>➦ Përshkruan ngjarjet duke përdorur shprehjet krahasuese (p.sh: sot hëngra |

| | | |
|---|---|---|
| disa alternativave.<br>➦ Emërton aspektet e ndryshme të një ngjarje/situate (p.sh: e bukur, e shkurtër etj.). | për të bërë krahasimin midis objekteve, të tilla, si: më shumë se... më pak se...; më tepër... se sa...etj. | më pak se dje).<br>➦ Shpjegon se *si* dhe *pse* ka marrë një vendim të thjeshtë.<br>➦ Merr parasysh vëzhgimet/ mendimet e shokëve/ shoqeve për objekte/ ngjarje të ndryshme para se të marrë një vendim. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 2**

- Vëzhgime dhe eksperimente të ndryshme për të nxjerrë të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet objekteve të ndryshme.
- Biseda, fotografi dhe komentime të emocioneve të përjetuara në një festë, ditëlindje apo aktivitet tjetër.
- Veprimtari praktike për të krahasuar objekte sipas madhësisë, ngjyrës dhe formës.

**Standardi 3: Fëmija kërkon zgjidhje të shumëfishta për detyrat dhe problemet**

**Treguesit për standardin 3**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Kërkon ndihmë nga një fëmijë/ i rritur për të zgjidhur një problem. | ➦ Provon mënyra të ndryshme për të zgjidhur një problem/ situatë problemore dhe zgjedh në fund njërën prej tyre.<br>➦ Bën pyetje të cilat duhet të marrin përgjigje me qëllim zgjidhjen e një problemi/ situate problemore. | ➦ Punon në grup me të tjerët për të zgjidhur një problem/ situatë problemore dhe provon strategji të ndryshme.<br>➦ Dallon menjëherë nëse gjendet përballë një situate të vështirë apo të lehtë (p.sh: me ta parë një pazëll |

| | | |
|---|---|---|
| | | thotë: ky pazëlli më duket se është i vështirë ose e bëj menjëherë).<br>➦ Rishikon veprimet/ strategjinë e përdorur për të zgjidhur një problem kur elemente të reja ndërhyjnë në situatë/ kontekst. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 3**

- Improvizime të situatave të thjeshta problemore që kërkojnë zgjidhje nga fëmijët.
- Lojë didaktike "Peshko dhe numëro peshqit në rrjetë, gjatë së cilës fëmijët do të gjejnë mënyra për të "peshkuar" sa më shumë peshq.
- Loja "Mos u nxeh".

**Standardi 4. Fëmijët përdor simbole për të paraqitur objekte.**

**Treguesit për standardin 4**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Identifikon simbolet për objekte të njohura.<br>➦ Bën përshkrim relativisht të plotë të një personi/ objekti që nuk është prezent. | ➦ Përdor simbolet e pikturave si përfaqësime të gjuhës së folur.<br>➦ Përdor objektet për të përfaqësuar cilësi reale në lojërat "Bëj gjoja sikur.."<br>➦ Përfaqëson objekte nëpërmjet vizatimeve, lëvizjeve, mimikës dhe | ➦ Përdor objekte fizike për të modeluar gjuhën (p.sh: kur dëshiron të përshkruajë diçka).<br>➦ Bën vizatime dhe përdor simbole për të përshkruar një situatë.<br>➦ Bën lidhjen midis objekteve dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | konstruksioneve 3-dimensionale. | simboleve (p.sh: kupton kush është tualeti për femra/ meshkuj nga simboli i vendosur mbi derë). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 4**

- Improvizohen situata ku nëpërmjet figurave ose shenjave shpjegohet domethënia e tyre.
- Improvizime të situatave "Në rrugë", "Në teatër", "Në dyqanin e lodrave" etj.
- Konkurs mes grupeve të fëmijëve për të emërtuar sa më shumë simbole e shenja të njohura.
- Tregime me figura dhe fjalë.

**Standardi 5. Fëmija shfaq njohuri për numrat dhe numërimin.**

**Treguesit për standardin 5**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Emërton disa numërorë.<br>➦ Kupton se numri tregon sasi.<br>➦ Përdor numrat gjatë numërimit të aktiviteteve që ka bërë gjatë një dite. | ➦ Numëron të paktën deri në 10.<br>➦ Mund të bëjë vlerësim me sy të një sasie deri në 5 objekte.<br>➦ Përdor shprehjet e duhura krahasuese sipas koncepteve, si: të gjithë, disa, asnjë, i njëjtë, më shumë, më pak etj.<br>➦ Diferencon numërorët nga shkronjat. | ➦ Numëron mbi 10 në mënyrë të pavarur.<br>➦ Kupton se numri i fundit në numërim përfaqëson sasinë totale të objekteve.<br>➦ Kryen llogaritje të thjeshta matematikore (mbledhje dhe zbritje) në jetën e përditshme.<br>➦ Përdor numrat për të parashikuar dhe ngritur hipoteza (p.sh: Unë mendoj se janë 5 kuba në shportë. Ja t'i |

| | | |
|---|---|---|
| | | numërojmë). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 5**

- Veprimtari praktike me numëratore.
- Improvizim situatash të thjeshta problemore, për të cilat fëmija gjen alternativa zgjidhjeje.
- Lojë simbolike “Kukulla ngjit dhe zbret shkallët”.
- Numra të thjeshtë shpejtësie, por që kërkojnë vëmendje dhe koordinim sy-dorë-objekt nga fëmijët.
- Fëmijës, gjatë lojës, i kërkohet të ndajë veç numrat e kartonit nga shkronjat.

**Standardi 6. Fëmija identifikon dhe emërton format.**

**Treguesit për standardin 6**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Identifikon dhe emërton rrethin, katrorin, trekëndëshin.<br>➦ Gjen menjëherë madhësinë dhe formën e objekteve pas pyetjes që i drejtohet (p.sh: cili top është më i madh?)<br>➦ Vizaton forma të ndryshme duke iu afruar deri diku saktësisë së saj.<br>➦ Kopjon format në përgjithësi saktë nga një model i dhënë. | ➦ Krijon dhe ndërton forma të bëra më parë nga të tjerët.<br>➦ Vizaton objekte sipas formës së tyre natyrale (p.sh: retë, pemët, kafshët etj.). | ➦ Kombinon format me njëra-tjetrën për të krijuar figura të reja.<br>➦ Dallon formën e ngjashme me një figurë gjeometrike në objektet në natyrë, duke marrë udhëzime nga të rriturit.<br>➦ Identifikon dhe emërton format tre-dimensionale si kubi, sfera, cilindri, koni etj.<br>➦ Dallon me një të parë nëse një figurë apo objekt i ngjan me formë apo me trup |

| | | |
|---|---|---|
| | | gjeometrik. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 6**

- Veprimtari praktike për gjetjen e objekteve me format e mësuara.
- Aktivitete ku fëmijëve u kërkohet të krijojnë figura duke përdorur format e njohura.
- Lodra konstruktive, shabllone, formuese etj.

**Standardi 7: Fëmija rendit, grupon, klasifikon dhe i organizon objektet duke u nisur nga madhësia, pesha, lartësia, gjatësia dhe vëllimi**

**Treguesit për standardin 7**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Mbledh sende që kanë karakteristika të përbashkëta (p.sh: gjethet me ngjyrë jeshile, lapsat e shkurtër etj.).<br>➦ Grupon objekte që shkojnë së bashku (p.sh: laps-fletë, këpucë- çorape, doreza – dorë)<br>➦ Përdor fjalët e duhura për gjatësinë dhe madhësinë.<br>➦ Dallon madhësinë e objekteve të ndryshme në jetën e përditshme (vendos sende krah për krah për të gjetur se cila është më e gjatë, e madhe)<br>➦ Identifikon figurën, objektin, sendin që është i madh ose i vogël, i rëndë ose i lehtë, i gjatë ose i shkurtër. | ➦ Rendit disa objekte për të ndërtuar diçka (p.sh: vendos blloqe në rresht për të ndërtuar një tren të gjatë).<br>➦ Dallon rregullin e renditjes së objekteve të dhëna.<br>➦ Rendit objektet sipas një cilësie të kërkuar.<br>➦ Përdor mjete matëse gjatë lojës (p.sh: kupa të madhësive të ndryshme në lojërat me ujë dhe rërë).<br>➦ Krahason me sy madhësinë, gjatësinë, peshën ndërmjet 2 objekteve (p.sh: Unë jam më i gjatë sa Ana).<br>➦ Etiketon objekte duke përdorur fjalët për madhësitë (p.sh:, gurë i madh, i rëndë). | ➦ Dallon menjëherë objektin që nuk i përket një grupi sendesh të dhëna.<br>➦ Ndan objektet në kategori në bazë të kritereve të kërkuara (madhësi, ngjyrë, formë, sasi etj.)<br>➦ Vazhdon dhe përshkruan modelimet e dhëna.<br>➦ Përshkruan *si* janë të organizuara ose të renditura objektet dhe përpiqet të japë edhe arsyen *pse*.<br>➦ Përdor mjete jo standarde të matjes (pëllëmbë, hap etj.).<br>➦ Mat me ndihmën e të tjerëve përbërësit e një recete (miell, ujë, sheqer).<br>➦ Mat rërën, ujin, orizin ose fasulet duke përdorur kupa/ gota/ filxhanë të madhësive të ndryshme. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 7**

- Veprimtari praktike për kryerjen e matjeve me njësi jo standarde.
- Veprimtari praktike për peshimin dhe matjen me njësi jo standarde.
- Veprimtari praktike me objekte dhe sende rrethanore për të praktikuar treguesit e standardeve.
- Improvizime situatash të thjeshta problemore, në të cilat fëmijët renditen, grupohen, ndahen sipas cilësive të kërkuara nga i rrituri.

**Standardi 8: Fëmija mbledh informacion për mjedisin dhe botën që e rrethon nëpërmjet vëzhgimit dhe hulumtimit, duke përdorur instrumente dhe metoda të ndryshme.**

**Treguesit për standardin 8**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Zgjeron njohuritë për mjedisin dhe kujdesi për ruajtjen e tij rritet.<br>➦ Kupton se mund të përdorë objekte për të hulumtuar në mjedis (p.sh.: provon me magnet në dorë se cilat objekte mund të tërheqë ai) | ➦ Merr pjesë së bashku me të rriturit, në eksperimente të thjeshta dhe është në gjendje të përshkruajë atë që ai / ajo vëzhgon (p.sh. kur në ujë hidhet një lëng tjetër me ngyrë etj.).<br>➦ Arrin të dallojë ndryshimet që ndodhin në natyrë dhe fillon të kuptojë lidhjen shkak-pasojë (p.sh: dolën yjet se u bë natë; do të shkoj në plazh se erdhi vera; gjethet po bien se erdhi vjeshta etj.) | ➦ Kërkon për informacion në lidhje me mjedisin nëpërmjet shqisave, eksperimenteve fillestare dhe vëzhgimit.<br>➦ Mbledh informacione nga burime të ndryshme në lidhje me një temë ose çështje të caktuar.<br>➦ Përshkruan dhe diskuton mbi një aktivitet që përfshin vëzhgimin dhe eksplorimin e botës së gjallë, krijesat e gjalla ose fenomenet natyrore. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 8**

- Eksperimente dhe vëzhgime të rezultateve që nxirren.
- Vëzhgime të dukurive që ndodhin me përdorimin e mjeteve dhe të objekteve shkencore, si magneti, lupa etj.
- Eksperimente të mbjelljes së bimëve.
- Ekskursione dhe shëtitje në natyrë.

**Standardi 9. Fëmija përfshihet në procesin e eksplorimit shkencor, bën dhe teston hipoteza të thjeshta, nxjerr konkluzione, bën parashikime.**

**Treguesit për standardin 9**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Përdor shqisat dhe mjetet e duhura për të hulumtuar mjedisin, për të mbledhur informacion dhe për të vëzhguar proceset, marrëdhëniet (xham zmadhues, magnet, lupën për të parë folenë e milingonave etj.). | ➦ Vëzhgon, ndjek dhe diskuton në lidhje me sende e objekte të ndryshme; bën dallime e krahasime ndërmjet objekteve, materialeve dhe fenomeneve që ndodhin.<br>➦ Përdor shqisat, shumëllojshmëri instrumentesh dhe aparate të thjeshta hetimi/ vëzhgimi (mikroskop). | ➦ Merr pjesë në eksperimente të thjeshta, diskuton dhe formulon konkluzione e përgjithësime të njohura.<br>➦ Mbledh informacion, regjistron të dhëna dhe informacione nëpërmjet metodave të ndryshme (p.sh nëpërmjet vizatimit, fotografive, tregimeve etj.) |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 9**

- Vëzhgime në mjedis të lëvizjes së milingonave, të reve në qiell, të diellit etj.
- Ekskursione në natyrë për grumbullimin e materialeve të ndryshme.

- Veprimtari praktike me gjethe për krahasimin e formës, ngjyrës dhe madhësisë së tyre.
- Përdorimi i mjeteve të ndryshme, si magneti dhe lupa për të vëzhguar më mirë insektet dhe sende të tjera.
- Eksperimente për mbjelljen dhe kujdesin për bimën. Nxjerrja e konkluzioneve në lidhje me nevojat që ka një bimë për t'u rritur.

**Standardi 10. Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës së gjallë.**

**Treguesit për standardin 10**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Vëren faktin se bimët rriten, lulëzojnë dhe ndryshojnë pamjen e tyre.<br>➦ Ndan krijesat e gjalla dhe bimët në varësi të mjedisit dhe në bazë të karakteristikave të tyre. | ➦ Dallon nëse një krijesë është e gjallë ose jo.<br>➦ Emërton objektet që i përkasin një grupi të caktuar (p.sh: mjetet që lëvizin në tokë, ajër, det).<br>➦ Tregon ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet grupeve të ndryshme të gjallesave apo dhe brenda të njëjtit grup.<br>➦ Sqaron marrëdhëniet e thjeshta që ekzistojnë ndërmjet, bimëve, kafshëve, mjedisit dhe njeriut.<br>➦ Bën pyetje dhe ofron shpjegime në lidhje ndërveprimin e qenieve të gjalla, mbi rritjen dhe të zhvillimin/shndërrimin e tyre. | ➦ Përshkruan dhe krahason nevojat themelore të qenieve të gjalla.<br>➦ Kupton si ndërveprojnë, jetojnë dhe përshtaten kafshët dhe bimët në mjedisin e tyre (p.sh: Peshkaqenët jetojnë në ujë dhe ushqehen me peshk).<br>➦ Shfaq interes për lindjen e të vegjëlve, jetën dhe vdekjen e tyre.<br>➦ Tregon interes për t'u kujdesur për një bimë ose për një kafshë shtëpiake.<br>➦ Mban qëndrimin e duhur në rastet kur vë re se dikush po dhunon një kafshë apo një bimë/ pemë. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 10**

- Vëzhgime në natyrë të rritjes së një bime.
- Lojë simbolike "Më ndihmoni të rritem" ku një bimë, apo kafshë kërkon kushte për t'u rritur e shëndetshme.
- Prezantime fotosh apo kartelash me figura ku jepen raste të kujdesit ose dëmtimit fizik të gjallesave të ndryshme.

**Standardi 11. Fëmija vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e botës jo të gjallë.**

**Treguesit për standardin 11**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bën pyetje rreth elementeve të jetës (tokë, ujit, ajrit, zjarrit).<br>➦ Përshkruan disa veti të materialeve dhe të objekteve përreth (ujë merr formën e enës ku hidhet, guri është i fortë).<br>➦ Përshkruan disa veti të stinës lidhur me karakteristikat e motit dhe veshjet e tyre. | ➦ Emërton mjediset që sheh në natyrë (malin, fushën, lumin etj.)<br>➦ Kupton dhe flet për rëndësinë e ujit dhe të ajrit për jetën si dhe zgjidhje të thjeshta për t'i mbrojtur ato.<br>➦ Emërton dhe dallon pjesë të ndryshme të kohës (ditën, natën; ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit etj.).<br>➦ Lidh ditët e javës me veprimtari që kryen vetë ose me familjen gjatë tyre. (E njëjta gjë mund të thuhet edhe për stinët dhe muajt e tyre). | ➦ Përshkruan karakteristikat e stinëve.<br>➦ Identifikon dhe dallon në mes të sipërfaqeve (p.sh e sheshtë/ malore), apo llojet e masave ujore (p.sh: lumë/ liqen/ det etj).<br>➦ Emërton stinët në mënyrë korrekte sipas radhës (pranverë, verë, vjeshtë, dimër).<br>➦ Përshkruan zhvillimin e mundshëm të motit dhe ilustron karakteristikat e një lloji të motit (duke përdorur simbole të përbashkëta për shi, diell, mot i vrenjtur etj.). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 11**

- Veprimtari praktike për veçimin e figurave që paraqesin qënie të gjalla nga qëniet jo të gjalla.
- Eksperimente dhe vëzhgime të ndryshimeve që ndodhin me një bimë nëse ujitet apo jo, lihet në dritë apo në errësirë etj.
- Lojë simbolike "Në park" "Në dhomën time" ku fëmijët dallojnë veprimtaritë që kryhen ditën dhe natën.
- Improvizime të mjediseve fizike të përshtatura për secilën stinë.

**Standardi 12. Fëmija dallon nëse një ngjarje ka ndodhur në të kaluarën, po ndodh tani apo mund të ndodhë në të ardhmen.**

**Treguesit për standardin 12**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Tregon në mënyrë kronologjike histori a ngjarje të thjeshta (por jo gjithmonë).<br>➦ Përdor fjalë dhe koncepte kohore (p.sh.: i pari/ i fundit, në mëngjes/ në darkë, dje/ sot/ nesër)<br>➦ Bën përshkrime të shkurtra të gjërave që kanë ndodhur gjatë ditës. | ➦ Parashikon gjërat që mund të ndodhin më pas (në kohë).<br>➦ Kupton se fëmijët e tjerë kanë një të shkuar të ndryshme nga e tij/ e saj.<br>➦ Përdor fraza që përkojnë me kohën/periudhën kur ka ndodhur një ngjarje në kohën e shkuar (p.sh: "kur isha bebe…") | ➦ Tregon në mënyrë kronologjike histori a ngjarje më komplekse.<br>➦ Gjatë rrëfimit, përdor emrat e ditëve të javës (herë-herë edhe të muajve).<br>➦ Fillon të kuptojë se në të shkuarën njerëzit jetonin ndryshe nga si jetojnë sot.<br>➦ Përdor kohën e ardhme për të diskutuar mbi planet e tij/e saj.<br>➦ Vendos marrëdhënie shkakësore mes ngjarjeve të ndodhura në të shkuarën, të |

| | | |
|---|---|---|
| | | tashmen ose që mund të ndodhin në të ardhmen.<br>➦ Dallon simbolet kryesore të vendit (p.sh.: flamurin shqiptar) |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 12**

- Improvizime situatash ku fëmijët imagjinojnë sikur kanë jetuar dikur apo do të jetojnë në të ardhmen.
- Lojëra simbolike me temë: "Më parë kishte...., tani ka...."
- Situata të thjeshta problemore të cilave u gjendet zgjidhja në kontekste të ndryshme kohore.

**Standardi 13. Fëmija demonstron njohuri për vendndodhjen, për marrëdhëniet midis njerëzve, vendeve dhe rajoneve.**

**Treguesit për standardin 13**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Përdor fjalët e duhura për të treguar drejtimin apo vendndodhjen e një objekti.<br>➦ Krijon përfaqësime të hapësirës gjatë lojës (p.sh: ndërton rrugë malore në këndin e rërës)<br>➦ Lidh/ bashkon objektet me vendndodhjen e tyre gjeografike | ➦ Dallon disa karakteristika të rajonit (gjeografik) ku jeton (p.sh: kur shikon në televizor se në një qytet ka rënë borë, fëmija shprehet se në qytetin ku jeton nuk ka rënë asnjëherë borë).<br>➦ Dallon se rrugët kanë shenja apo emra dhe shtëpitë kanë numra për të identifikuar vendndodhjen e tyre. | ➦ Fillon të kuptojë se hartat janë përfaqësime të vendeve të ndryshme në botë.<br>➦ Kupton dhe dallon se vendet reale mund të përfaqësohen me simbole.<br>➦ Përshkruan disa karakteristika fizike të vendeve dhe karakteristikat përkatëse të komuniteteve që jetojnë në ato vende. |

| | | |
|---|---|---|
| (p.sh: sobën në kuzhinë, krevatin në dhomën e gjumit, pemën në park etj.). | ➦ Flet për vendndodhjen duke përdorur fjalorin e përshtatshëm si p.sh: afër/ larg, mbi/ nën, pranë, ngjitur etj.<br>➦ Dallon nëse një vend ndodhet afër apo larg vendit ku banon (p.sh: thotë që shtëpia e tij/e saj është shumë larg/ afër me shtëpinë e gjyshes). | ➦ Fillon të kuptojë se njerëzit në vende të ndryshme kanë zakone, veshje e sjellje të ndryshme. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 13**

- Veprimtari praktike ku fëmijët përshtasin objektet me mjedisin të cilit i përkasin.
- Improvizime mjedisesh të ndryshme, si kuzhinë, dhomë gjumi, bibliotekë dhe pajisja e tyre me objektet e duhura.
- Udhëtim me autobus rreth e qark qytetit - shëtitje me këmbë nëpër fshat.
- Vizitë në muzeun historik dhe etnografik të qytetit.

**Standardi 14. Fëmija kupton se marrëdhëniet midis njerëzve janë në funksion të shkëmbimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.**

**Treguesit për standardin 14**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Fillon të kuptojë se paratë janë të nevojshme për blerjen e të mirave dhe të shërbimeve.<br>➦ Kupton se të rriturit punojnë që të fitojnë para për të blerë ushqime, lodra, veshje, për të vajtur në pushime etj.<br>➦ Flet rreth çështjes se të gjithë njerëzit kanë nevojë për ushqim, strehim dhe veshmbathje (të drejtat kryesore).<br>➦ Tregon se çfarë ka dëshirë të bëhet kur të rritet, duke e justifikuar dëshirën që shfaq. | ➦ Luan "dyqanesh"dhe vihet në rolin e shitësit ose të blerësit dhe përdor para, karta supermarketi, fatura (të vërteta ose jo).<br>➦ Dallon sasinë e lekëve që i duhet për të bërë blerje (për lëpirëse duhen pak lekë, për kompjuterin duhen shumë). | ➦ Kupton konceptin e ruajtjes/ të kursimit të burimeve për t'i përdorur në të ardhmen.<br>➦ Kupton se njerëzit mbështeten tek njëri-tjetri për të mirat dhe shërbimet që i ofrojnë njëri-tjetrit. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 14**

- Lojë me role "Unë shkoj në kopsht, mami dhe babi në punë"
- Lojë simbolike "doktorash, shtëpish, profesionesh të ndryshme".
- Improvizime situatash ku fëmijët ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

- Panaire, në të cialt fëmijët shesin me çmime simbolike produkte të ndryshme dhe bëjnë plan për shpenzimin e të ardhurave.

**Standardi 15. Fëmija përdor në mënyrë të përshtatshme disa pajisje teknologjike dhe tregon ndikimin e tyre në jetën e përditshme.**

**Treguesit për standardin 15**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Shfaq interes për pajisjet teknologjike dhe mënyrën si përdoren.<br>➦ Flet në telefon me pjesëtarët e familjes për biseda të ndryshme. | ➦ Përdor kompjuterin për lojëra dhe efekte të multimedias.<br>➦ Fut CD në kompjuter për të parë një film apo për të luajtur.<br>➦ Hap dhe mbyll vetë faqe lojërash. | ➦ Jep shembuj që tregojnë si i ndihmon teknologjia njerëzit për të arritur detyra specifike.<br>➦ Me ndihmën e të rriturit, fillon të kuptojë si kanë vepruar njerëzit më parë në mungesën e teknologjisë.<br>➦ Kupton përdorimin dhe keqpërdorimin e teknologjisë.<br>➦ Fillon të përdorë kompjuterin me ndihmën e të rriturit, për faqe dhe programe të përshtatshme për të vegjëlit. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 15**

- Realizime vizatimesh të thjeshta me kompjuter e celular.
- Improvizime të situatave apo të kushteve në kohëra të ndryshme.

**Standardi 16. Fëmija kupton strukturën e familjes, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj.**

**Treguesit për standardin 16**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Dallon rolet e anëtarëve brenda familjes.<br>➦ Identifikon veten si pjesëtar i familjes dhe i përkatësisë së një grupi.<br>➦ Merr pjesë në lojë me role: Ushqen kukullën dhe bisedon me të, si vepron e ëma me të.<br>➦ U vendos emra kukullave dhe lodrave të veta.<br>➦ Zbaton rregullat me ndihmën e të rriturve.<br>➦ Tregon interes për mjedisin ku jeton dhe imiton veprimet e të rriturve në mirëmbajtjen e tij. | ➦ Përshkruan rolet e anëtarëve të familjes dhe tregon lidhjet që ka me ta.<br>➦ Flet për gjyshërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.<br>➦ Imiton marrëdhëniet në familjen e tij/ e saj gjatë lojës në role.<br>➦ Ndihmon në punët e shtëpisë.<br>➦ Kryen me devotshmëri detyrat që i ngarkohen brenda familjes. | ➦ Njeh anëtarët e tjerë të fisit.<br>➦ Eksploron rolet e anëtarëve të familjes në funksione më specifike.<br>➦ Fillon të kuptojë marrëdhëniet e rrethit familjar ndërmjet kushërinjve, vëllezërve e motrave të prindërve.<br>➦ Flet me fëmijët e tjerë për marrëdhëniet, jetën, aktivitetet, festimet që bëhen në familjen e tij/e saj.<br>➦ Krijon pemën e familjes së vet.<br>➦ Respekton rregullat e mirësjelljes brenda dhe jashtë familjes.<br>➦ Kupton që ka lloje të ndyshme të familjeve. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 16**

- Lojë në role “Në familje”
- Improvizime situatash dhe kontekstesh të ndryshme që përjetohen në jetën e përditshme apo në ditë të shënuara nga një familje.

**Standardi 17. Fëmija demonstron njohuri për komunitetin, ndërvarësinë midis njerëzve, role të ndryshme sociale dhe përgjegjësinë qytetare.**

**Treguesit për standardin 17**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Tregon interes për shokët e grupit dhe përfshihet në lojë me ta, duke i thërritur në emër.<br>➦ Fillon të kuptojë që njerëzit kanë role dhe punë të ndryshme në komunitet.<br>➦ Tregon se ç'ndihmë mund të japë ai në kopsht e në komunitet.<br>➦ Tregon interes për punonjësit e shërbimit në komunitet.<br>➦ Zbaton me ndihmën e të rriturve rregullat e mirësjelljes.<br>➦ Shkëmben me vështirësi lodrat e veta me ato të shokëve.<br>➦ I tregon gabimet që bën kur pyetet për to. | ➦ Shfaq interes për profesionet që i ndesh në jetën e përditshme.<br>➦ Dallon cilat janë mjetet apo veglat e punës që përdoren në profesione të njohura.<br>➦ Formon numrin e ambulancës, të policisë dhe zjarrfikëses.<br>➦ Merr pjesë në lojëra që lidhen me profesione të ndryshme, duke interpretuar një rol të caktuar. | ➦ Shfaq interes për punët e ndryshme që bëjnë njerëzit në komunitet.<br>➦ Shfaq sjellje të mira sociale në punë të përbashkëta dhe në detyra që i caktohen .<br>➦ Përfshihet, pa ia kërkuar, në punë të ndryshme së bashku me shokët dhe shoqet e tjera.<br>➦ Merr pjesë me gëzim në festimin e ditëve dhe ngjarjeve të shënuara.<br>➦ Merr pjesë me dëshirë në ditëlindjet e shokëve dhe në ngjarje të tjera të gëzueshme. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 17**

- Lojë në role "Në komunitet".

- Improvizime situatash dhe kontekstesh të ndryshme që përjetohen në jetën e përditshme apo në ditë të shënuara në komunitet.
- Lojë me role “Profesionet”.
- Veprimtari praktike “Kujdesi për mjedisin ku jetojmë”.

**Standardi 18. Fëmija dallon ndryshimet kulturore ndërmjet njerëzve dhe i pranon ato.**

**Treguesit për standardin 18**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Shfaq interes për të dëgjuar nga të tjerët çfarë thonë për jetën në familjen e tyre. | ➦ Me ndihmën e të rriturit bën diferencën midis njerëzve dhe vendeve të kulturave të ndryshme.<br>➦ Shfaq interes për mënyrën e festimit të një feste në vende të ndryshme.<br>➦ Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve. | ➦ Fillon të kuptojë rreth ngjashmërive dhe ndryshimeve që kanë fëmijët e kulturave të ndryshme.<br>➦ Shfaq interes për të marrë pjesë në festime tradicionale të kulturave të tjera.<br>➦ Tregon respekt për të tjerët edhe pse janë ndryshe prej tij/saj.<br>➦ Shfaq interes për të mësuar më tepër rreth kulturave të ndryshme. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 18**

- Improvizime aktivitetesh në të cilat fëmijët mund të shfaqin traditat dhe zakonet familjare, krahinore e më gjerë.
- Shfaqje me këngë e valle popullore të zonës.
- Sfilatë me veshjet popullore të zonës.

- Vizitë në muzeun etnografik.
- Ndeshje ose gara të lidhura me traditat e zonës.

**Standardi 19. Fëmija përdor artin për të shprehur atë çfarë di, mendon, beson dhe ndjen.**

**Treguesit për standardin 19**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Fëmija njeh dhe imiton tingujt e kafshëve të njohura (qeni, macja, lopa, pula, delja etj.)<br>➦ Shfaq interes për një numër të caktuar këngësh, vallesh, pjesësh muzikore.<br>➦ Tregon këngën (ndonjëherë edhe emrin e këngëtarit/es) që pëlqen.<br>➦ Prodhon ritme dhe tinguj me mjete rrethanore ose instrumente të thjeshta.<br>➦ Eksperimenton me dëshirë me përzierje bojërash. | ➦ Dallon nëse ritmi i muzikës është i shpejtë ose i ngadaltë.<br>➦ Mban mend tekstin e një kënge që përsëritet shpesh.<br>➦ Shoqëron me lëvizje trupi këngën që këndon ose dëgjon.<br>➦ Ndjek ritmin e përplasjes së duarve nga i rrrituri për të shoqëruar një këngë.<br>➦ Shfaq interes për të përdorur teknika dhe materiale të ndryshme vizatimi.<br>➦ Përdor stampa për të vizatuar ose ngjyrosur.<br>➦ Shpreh në vizatim gjendjen emocionale.<br>➦ Vizaton pa ndihmën e të rriturit atë që ka dëshirë/ në mendje. | ➦ Këndon pa ndihmë këngët që i ka mësuar përmendësh.<br>➦ Kur këndon në grup përpiqet të koordinohet me të tjerët.<br>➦ Përdor materiale dhe teknika të ndryshme gjatë realizimit të punimeve artistike.<br>➦ Përdor muzikën për të shprehur mendimet, ndjenjat dhe energjinë e tij/e saj.<br>➦ Përdor/ sajon instrumente të thjeshta muzikore.<br>➦ Interpreton rënien e gjetheve, fluturimin e zogut, kërcimin e lepurit etj. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 19**

- Eksperimente për përzierje ngjyrash.
- Kolazhe me materiale, mjete të ndryshme/
- Veprimtari praktike për krijimin e instrumenteve të thjeshta muzikore me mjete rrethanore.

**Standardi 20. Fëmija zhvillon njohuri dhe aftësi vlerësuese për artin.**

**Treguesit për standardin 20**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Shikon fëmijët e tjerë që kërcejnë dhe pastaj përpiqet të kopjojë hapat e tyre.<br>➦ Shpreh nëse i pëlqen ose jo një shfaqje, ekspozitë, koncert, teatër etj. | ➦ Lëviz nën ritmin e muzikës që luhet në momente të qeta.<br>➦ Tregon si ndihet kur dëgjon pjesë të ndryshme muzikore.<br>➦ Shfaq mendimin e tij/e saj për vizatimin e shokut, por pa hyrë në arsyetime.<br>➦ Jep mendimin se kush ka punuar më bukur në një punim me të njëjtën tematikë. | ➦ Jep arsye pse i pëlqen ose jo një pikturë/ vizatim/ muzikë, shfaqje etj.<br>➦ Përshkruan çfarë kupton në një vepër arti.<br>➦ Jep vlerësimin e tij/e saj për interpretimin, vizatimin, këndimin, kërcimin e të tjerëve. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 20**

- Dëgjimi i këngëve për fëmijë dhe përshkrimi i emocioneve që përjetojnë fëmijët.
- Lojëra muzikore.
- Vizitë në shfaqje, koncerte, ekspozita etj.
- Dramatizime dhe lojë në role.

# FUSHA: ZHVILLIMI GJUHËSOR, LEXIMI DHE SHKRIMI

## Përshkrimi i fushës

Fusha “Zhvillimi gjuhësor, leximi dhe shkrimi” ka të bëjë me fitimin e aftësisë për ta kuptuar dhe për ta përdorur gjuhën. Para se fëmijët të thonë fjalë ose t’i bashkojnë ato në fjali, ata janë shumë aktivë në mësimin e gjuhës. Brenda pak vitesh fëmijët e vegjël kalojnë nga faza “*e komunikimit pa fjalë*” në oratorë të shkëlqyer që në mënyrë të gjallë tregojnë ose shpikin histori.

Sipas studimeve të kryera, fëmijët e vegjël, që kanë fjalor të pasur dhe përvoja leximi dhe shkrimi herët në jetë, kanë më pak gjasa të kenë vështirësi të mësojnë të lexojnë më vonë në shkollë. Fjalori i fëmijëve parashkollorë përmban fjalë që lidhen me ngjarje, situata dhe dukuri me të cilat ata ndeshen në jetën e përditshme. Fëmijët interesohen për gjërat që i rrethojnë, bëjnë pyetje, japin përgjigje, luajnë me fjalë, vizatojnë figura që paraqesin njerëz, kafshë dhe sende, përdorin "shkrimin" si mënyrë për të shprehur ose për të treguar një histori; e përdorin gjuhën jo vetëm për të biseduar, por edhe për të shkëmbyer informacion.

### Nënfushat dhe përshkrimi i tyre

## 4.1 Të dëgjuarit dhe të folurit

## 4.2 Të lexuarit

## 4.3 Të shkruarit

**Të dëgjuarit dhe të folurit.** Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve përfshin të folurin dhe të dëgjuarin përmes fjalorit, njohurive gramatikore dhe sintaksore, të kuptuarit dhe gjuhën e folur. Fjalori i tyre rritet në varësi të përdorimit të fjalëve të larmishme prej të rriturve. Përdorimi i fjalorit në situata nga më të larmishmet, ndihmon, që fëmija të pasurojë fjalorin përpara se ta përdorë atë në kontekstin e duhur. Përdorimi i saktë i gjuhës nga ana gramatikore dhe sintaksore, zbulimi i disa rregullave bazë të gramatikës,

përdorimi i saktë i fjalëve me trajta gjuhësore të çrregullta, tregon se fëmija po përparon në përdorimin e gjuhës sipas normave, me qëllim që ta kalojë qartë mesazhin tek dëgjuesi.

Përpara se bebet të thonë fjalën e parë, ata janë përgatitur ta përdorin gjuhën në shumë mënyra. Ndërkohë që fëmijët rriten, edhe nevojat e tyre për komunikim ndryshojnë. Fëmija 3-vjeçar mëson bazat e komunikimit, kurse parashkollorët janë komunikues të rrjedhshëm. Ata kanë mësuar shumë mbi qëllimet dhe mënyrat e komunikimit. Është e rëndësishme që të rriturit t'i mbështesin këto ndryshime, në mënyrë që fëmijët të vazhdojnë të rriten si komunikues të aftë. Bisedat, përshkrimet, këngët dhe vjershat promovojnë dhe nxisin zhvillimin gjuhësor të fëmijës. Ato e ndihmojnë fëmijën të kuptojë ritmin e gjuhës dhe modelet e ndërtimit të fjalisë. Një themel i shëndoshë i zhvillimit gjuhësor në vitet përpara se të fillojnë shkollën do mbështesë përpjekjen e mëtejme për të lexuar dhe shkruar.

**Të lexuarit**. Leximi fillon shumë më parë se fëmija të lexojë librin e parë. Sjelljet që paraprijnë leximin e pavarur fillojnë shumë herët. Për shembull, fëmijët e vegjël edhe 7–8 muaj, mund të gugasin dhe të belbëzojnë ndërkohë që tregojnë me gisht figurat e librit. Ky është një tregues se libri po u intereson. Ndërkohë që fëmijët hyjnë në moshën 3-vjeçare, sjellje të ngjashme me leximin fillojnë të shfaqen. Këto sjellje mund të përfshijnë leximin me gjasme ose leximin autentik. Më vonë fëmija mund "të lexojë" një libër, duke e ritreguar siç e ka dëgjuar nga i rrituri dhe mund të rrijë më gjatë i fokusuar në veprimtarinë e leximit me gjasme, sidomos në moshën parashkollore. Këta janë hapa të rëndësishëm në zhvillimin e leximit.

**Të shkruarit.** Shkrimi është pjesë e rëndësishme e zhvillimit gjuhësor dhe i komunikimit. Të mësuarit e leximit dhe të mësuarit e shkrimit janë dy procese të rëndësishme të zhvillimit gjuhësor që mbështesin njëra-tjetrën. Shpesh, fëmijët me aftësi të mira shkrimi kanë aftësi të mira leximi dhe anasjelltas. Shkarravinat e rastësishme që bën një dyvjeçar janë tregues i zhvillimit të shkrimit. Ndërkohë që muskujt forcohen, fëmijët kanë më shumë kontroll ndaj shkarravinave, duke i bërë në formë lineare. Rreth moshës 4-vjeçare, fëmijët bëjnë forma të ngjashme me shkronjat, me forma të çrregullta dhe të shkruara në mënyrë rastësore. Por është e rëndësishme në këtë fazë të kuptojmë se fëmijët e kanë konceptin e shkrimit, pasi ata e dallojnë atë nga vizatimi. Në moshën parashkollore, fëmijët shkruajnë fjalë me shkronja mungesore, kryesisht duke rrëzuar zanoret, duke filluar të përdorin dhe shenjat e

pikëzimit në mënyrë rastësore. Në fund të kësaj moshe, shumë prej fjalëve shkruhen saktë, përdorin hapësira mes fjalëve, duke shkruar nga e majta në të djathtë dhe nga lart poshtë në fletë.

## 4.4 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE

| | |
|---|---|
| **IV.1 Të dëgjuarit dhe të folurit** | **Standardi 1.** Fëmija dëgjon dhe merr informacion për botën që e rrethon.<br>**Standardi 2.** Fëmija tregon aftësi në rritje për të dëgjuar kur flasin të rriturit apo fëmijë të tjerë.<br>**Standardi 3.** Fëmija ua komunikon mendimet, ndjenjat apo ngjarjet që përjeton të rriturve dhe fëmijëve të tjerë.<br>**Standardi 4.** Fëmija drejtshqipton tingujt, shkronjat dhe fjalët më të përdorura. |
| **IV.2 Të lexuarit** | **Standardi 5.** Fëmija shfaq interes për të lexuarit. |
| **IV.3 Të shkruarit** | **Standardi 6.** Fëmija kupton qëllimin e shkrimit.<br>**Standardi 7.** Fëmija shfaq aftësi në rritje për të kuptuar vlerën e simbolit të fjalës e shkronjës, e më vonë vetë simbolin. |

## 4.5 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE

**Standardi 1. Fëmija dëgjon dhe merr informacion për botën që e rrethon.**

**Treguesit për standardin 1**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Vepron kur i jepen udhëzime që kërkojnë realizimin e veprimeve me dy deri në tre komanda (p.sh: *Shko tek rafti, merr topin e kuq dhe ma sill*).<br>➦ Lidh në përgjithësi saktë fjalën e dëgjuar me figurën ose objektin.<br>➦ Pyet për fjalët që nuk i di dhe kënaqet kur i përdor në përvojat e jetës së përditshme.<br>➦ Shprehet me fjalë 2 deri në 3 rrokëshe.<br>➦ Kërkon ndihmën e të tjerëve për të emërtuar objektet e panjohura.<br>➦ Bën pyetje të thjeshta.<br>➦ Përshkruan me një ose dy fjali një vizatim të bërë vetë.<br>➦ Përdor fjali në "ligjërimin" e vet, por mund të mos përdorë korrekt rregullat e gramatikës ose të drejtshqiptimit.<br>➦ Mund të thotë një fjali me dy –tre fjalë në të cilën ka një emër dhe një | ➦ Dëgjon me vëmendje në grup për një kohë të shkurtër (deri në 4-5 minuta).<br>➦ Tregon, kur i kërkohet, deri në 6 pjesë të trupit të tij.<br>➦ Mund të emërtojë disa njerëz, sende dhe lëvizje.<br>➦ Kupton dhe zbaton udhëzimet për veprime si *vrapo, kërce, hape, merre, hyr etj.*<br>➦ Mban mend lehtësisht fjalët e reja dhe provon të kujtojë kuptimin e tyre, edhe pse mund t'i harrojë shpejt.<br>➦ Përshkruan veprime dhe cilësinë e kryerjes, duke përdorur saktë lidhjen mes foljes dhe ndajfoljes p.sh:, *vrapon shpejt, luan mirë* etj.<br>➦ Flet zakonisht duke përdorur fjali me 2-3 fjalë.<br>➦ Bën pyetje për të marrë një informacion.<br>➦ Përshkruan një punim ose ngjarje | ➦ Dallon kuptimin e fjalëve kur ato janë ose jo me kuptim të figurshëm.<br>➦ Përdor saktë fjalë teknike ose specifike për një profesion të caktuar (p.sh:, *mekaniku rregullon makinat).*<br>➦ Kupton zakonisht sinonimet *(fjalët me kuptim të njëjtë ose të ngjashëm)*, dhe rrallëherë edhe antonimet *(fjalët me kuptim të kundërt).*<br>➦ Përdor fjalët e reja në lidhje me kontekstin.<br>➦ Mëson kuptimin e fjalëve të panjohura më parë dhe i përdor duke treguar se ua di domethënien.<br>➦ Përdor fjalë me kuptim abstrakt të tilla si: *miqësi, fëmijëri, dashuri* etj.<br>➦ Ndërton fjali me një rrjedhë të qartë logjike.<br>➦ Flet me fjali të ndërtuara saktë nga ana gramatikore.<br>➦ Ndërton fjali të thjeshta dhe të përbëra me folje, emra dhe përemra.<br>➦ Përdor në mënyrë korrekte kohën e foljeve.<br>➦ Tregon lehtësisht histori të ndara në 3 pjesë |

| | | |
|---|---|---|
| folje.<br>➦ Përdor saktë format mohore, p.sh:, ***Nuk*** *dua të luaj*.<br>➦ Mund të "krijojë" apo të "shpikë" fjalë, që kanë kuptim vetëm për njerëzit e afërt.<br>➦ Të folurit e fëmijës nuk kuptohet mirë nga të rriturit që nuk janë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijët. | me 2-3 fjali.<br>➦ Përdor shumësin e emrave dhe mbiemrave edhe pse me gabime.<br>➦ Të folurit e fëmijës bëhet gjithmonë e më i kuptueshëm. | që përkojnë me fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e saj.<br>➦ Përshkruan ngjarjet e një historie dhe personazhet e saj.<br>➦ Të folurit e fëmijës është lehtësisht i kuptueshëm nga të rritur të tjerë të panjohur me të. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 1**

- Përshkrim i një kartele me figura, libra me figura dhe simbole ku komentohet dhe diskutohet rreth tyre.
- Ushtrime gjuhësore ku përdoren tabela, foto, kartela duke gjetur fjalën e re të mësuar.
- Lexim me ndërprerje për t'u siguruar nëse fëmijët po ndjekin me anë të pyetjeve çfarë, kur, ku, si, etj.
- Angazhimi i fëmijeve në bashkëbisedime me njëri-tjetrin gjatë ditës dyshe-dyshe ose në grupe te vogla.
- Zbatim i udhëzimeve të mesueses me 2-3 komanda; imitime të lëvizjeve sipas kuptimit të fjalëve të dhëna.
- Lojëra me role ku fëmijët imitojnë sipas profesioneve.
- Lojëra didaktike p.sh."Gjej të kundërtën"."Gjej të ngjashmen" ku fëmijët gjejnë fjalët e kundërta ose të ngjashme (sinonimet dhe antonimet) nëpërmjet figurave.

**Standardi 2. Fëmija tregon aftësi në rritje për të dëgjuar kur flasin të rriturit apo fëmijë të tjerë.**

**Treguesit për standardin 2**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Dëgjon një tregim të shkurtër me kënaqësi për më pak se 10 minuta.<br>➦ Ritregon një ngjarje të dëgjuar, i ndihmuar nga mësuesja ose shokët, duke iu referuar fillimit, vazhdimit dhe përfundimit.<br>➦ Kërkon t'i dëgjojë disa herë përrallat apo ngjarjet e njohura.<br>➦ Tregon të paktën një detaj nga një histori e dëgjuar pak më parë.<br>➦ Imiton zhurmat/ tingujt e objekteve, p.sh:, sinjalin e alarmit të ambulancës.<br>➦ Imiton të folurit e të rriturve.<br>➦ Tregohet i vëmendshëm ndaj folësit.<br>➦ Merr pjesë në diskutimet e një grupi prej prej 3-4 vetësh.<br>➦ Kupton mesazhin përmes të dëgjuarit, dhe vepron sipas udhëzimeve me 1 deri 2 komanda. | ➦ Tregon një tregim të sapodëgjuar me pak ndihmë nga i rrituri apo shoku.<br>➦ Përcjell një mesazh me fjalët e veta.<br>➦ Flet dhe diskuton për tema të ndryshme.<br>➦ Dëgjon hollësitë e një ngjarjeje dhe mund t'i përsërisë ato.<br>➦ Dëgjon duke ndjekur me sy folësin gjatë një diskutimi apo bashkëbisedimi në grup të madh. | ➦ I pëlqen të dëgjojë tregime të regjistruara.<br>➦ Tregohet i vëmendshëm gjatë gjithë tregimit të një historie pa e ndërprerë folësin, nëse ngjarja e tërheq.<br>➦ Dëgjon të tjerët, merr pjesë në biseda e diskutime që zhvillohen në grup.<br>➦ Ritregon me fjalët e veta një tregim/ histori apo një ngjarje të ndodhur.<br>➦ Tregon qartë një ngjarje apo histori familjare në të cilën ka qenë i pranishëm. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 2**

- Tregime dhe përralla të shkurtra në figura, i tregon dhe i ritregon duke përdorur pauza, gjestikulacion gjatë leximit.

- Imitime të zërave të kafshëve dhe të personazheve të përrallave. Loje me role "Familja" ku fëmijët vihen të imitojnë pjesëtarë të familjes.
- Vizitë të dentisti, mjeku , në postë etj.
- Bashkëbisedim me të ftuar në klasë (mjek, gjyshe, polic, zjarrfikës etj.)
- U vihen në dispozicion libra me përralla dhe tregime të përshtatshme për grupmoshën.
- Vizitë në supermarket, në muze etj.
- Loja "Emisioni i lajmeve" ku fëmija çdo ditë tregon për një ngjarje të veçantë që ka ndodhur.
- Tregimi zinxhir me pazlla e figura.
- Komentim të figurave, albumeve me foto të bëra gjatë një feste familjare me foto të fëmijës nga 1-6 vjeç.

**Standardi 3. Fëmija ua komunikon mendimet, ndjenjat apo ngjarjet që përjeton të rriturve dhe fëmijëve të tjerë.**

**Treguesit për standardin 3**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ U përgjigjet me fjalë kërkesave të dhëna duke kryer veprime konkrete (2-3 kërkesa, që kanë lidhje me njëra-tjetrën).<br>➦ Përdor gjuhën e trupit për të shprehur nevojat dhe ndjenjat (p.sh:, jep një përqafim spontan).<br>➦ Përdor fjalë cilësuese (mbiemra apo ndajfolje) për të përshkruar një send apo ndodhi (Psh: *Lule e bukur,* | ➦ Shpreh me fjali të thjeshta gjendjen emocionale që po përjeton (P.sh: *u mërzita, u kënaqa, nuk më pëlqen etj.).*<br>➦ Përdor fjali me 3-4 fjalë për të komunikuar nevojat, idetë, veprimet ose ndjenjat e tij/e saj.<br>➦ Përsërit fjalët apo idetë për t'u siguruar se informacioni është i saktë. | ➦ Ndryshon intonacionin dhe tonin për të komunikuar domethënien.<br>➦ Përdor fjali të plota për të shprehur idetë, mendimet e veta, nevojat dhe ndjenjat.<br>➦ Përshtat stilin e komunikimit sipas dëgjuesit (P.sh:, kur flet me një fëmijë të vogël përdor fjalë të thjeshta).<br>➦ Tregon një histori duke bërë përshtatjen e zërit sipas personazheve.<br>➦ Përdor tone të ndryshme komunikimi në situata |

| | | |
|---|---|---|
| *gjuaj fort topin*).<br>➦ Përdor fjalët e mirësjelljes (p.sh:, *Të lutem!*, *Më fal!*, *Faleminderit!* etj).<br>➦ Bën kërkesë formale ose jep një përgjigje të tillë. si p.sh:, "T*a marr...? "Të lutem!", "Më fal!", "Faleminderit!"*, etj.<br>➦ Shoqëron të folurit me gjeste dhe mimikë. Nga veprimet që kryen të jep të kuptosh si ndihet. | ➦ Shpjegon me fjalë vizatimin e vet, komenton punimin e shokëve.<br>➦ Përdor fjalët përshëndetëse më të përdorura.<br>➦ Shpreh mendimin /idenë e vet duke mbajtur një qëndrim (p.sh:, thotë nëse e pëlqen apo nuk e pëlqen diçka/ dikë).<br>➦ Tregohet i vëmendshëm ndaj folësit rreth 10 minuta, nëse tema i intereson. | të ndryshme (P.sh.: pëshpërit kur një fëmijë fle).<br>➦ Përdor gjuhën e duhur sipas qëllimit të komunikimit; po tregon një histori, po merr informacion, kërkon ndihmë etj.<br>➦ Lidh në mënyrë harmonike fjalët me gjeste kur flet, tregon apo reciton një vjershë.<br>➦ Ndërton një ngjarje të shkurtër në bashkëpunim me fëmijët e tjerë. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 3**

- Ofrohet një shumëllojshmëri objektesh, lodrash, sendesh, maskash, veshjesh që fëmijët të imitojnë apo të luajnë role të ndryshme sipas tematikave të caktuara dhe përshkrimi i cilësive specifike të tyre.
- Lojë me pantonime.
- Fëmijët vihen të interpretojnë gjendje emocionale të ndryshme nëpërmjet gjuhës së trupit.
- Improvizim situatash.
- Fëmijët vihen të improvizojne ngjarje dhe situata nga jeta e përditshme ne kopsht, në familje etj.
- "Loja e Pasqyrës" (Bën gjeste pëpara pasqyrës dhe i interpreton ato duke zbatuar komandat e dhëna nga i rrituri apo nga një bashkëmoshatar.
- Sigurimi i mjeteve dhe krijimi i hapësirave për të shkruar, vizatuar dhe pikturuar.

- U ofrohen libra, tablo ilustruese për histori a ngjarje të ndryshme dhe bëhet komentimi i figurave apo vizatimeve sipas rrjedhës së ngjarjeve.
- Dramatizime të pjesëve të ndryshme teatrale.
- Krijim me vizatime të një historie (nje ngjarje e jetuar, e dëgjuar apo një përrallë të punuar në kopsht) etj.

**Standardi 4. Fëmija drejtshqipton tingujt, shkronjat dhe fjalët më të përdorura.**

**Treguesit për standardin 4**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Plotëson fjalën e fundit të një vargu të rimuar që e ka mësuar më parë.<br>➦ Merr pjesë në lojërat me këngë me fëmijët e tjerë.<br>➦ Ndjek ritmin që dëgjon (*p.sh: duke përplasur duart shpejt ose ngadalë*).<br>➦ Përdor fjalën e duhur për vizatimin/ figurën që i tregohet.<br>➦ Dallon shkronjën e parë të emrit të vet. | ➦ Dallon në një vizatim objektet, emri i të cilave fillon me të njëjtën shkronjë-tingull.<br>➦ Identifikon tingullin e parë të fjalës me ndihmën e një të rrituri (*p.sh: deti fillon me d).*<br>➦ Dallon tingujt, edhe pse mund të ketë vështirësi në drejtshqiptimin e disa prej tyre (k, l, r, rr, sh, th *etj).*<br>➦ Gjen dhe lexon emrin e vet të shkruar me shkronja kapitale. | ➦ Shqipton drejt tingujt e gjuhës amtare.<br>➦ Dallon zanoret nga bashkëtingëlloret.<br>➦ Dallon tingujt nistorë nga ata fundorë tek fjalët e njohura.<br>➦ Gjen fjalën që formohet me shkronjat e dhëna.<br>➦ Kupton se kur ndryshohet tingulli-shkronja nistore në një fjalë mund të krijohet një fjalë e re. *(p.sh:, **f**jalë -**d**jalë; **m**uri-**g**uri, **d**ora-**b**ora; **k**ap -**j**ap; etj. )*<br>➦ Lexon shkronjat e alfabetit. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 4**

- Lojëra muzikore të ndryshme ku fëmijët këndojnë, imitojnë dhe ndjekin ritmin që dëgjojnë.

- Shfletim të librave me figura, kartela, libra me një ngjarje të caktuar, ku fëmijët përdorin fjalën e duhur për figurën e dhënë etj.
- U ofrohen fëmijëve etiketa me figura dhe fjalë dhe fëmija njeh shkronjën e parë të fjalës së dhënë.
- Shkrimi i emrit me shkronja kapitale.
- Gjej shkronjën që i përket tingullit. Përzgjedhja e kartelave me figura emri i të cilave fillon me një shkronjë të caktuar nga mësuesja.
- Formim fjalish sipas një simboli që shikon p.sh. (ulja në karrige në kinema sipas shenjave).
- U ofrohen fëmijëve figura, shkronja, kartela me të cilat krijohen lojëra të ndryshme gjuhësore.
- Improvizim situate.
- "Paraqitja e nje reklame" ku fëmijët tregojnë ,shqiptojnë, bëjnë sikur lexojnë, përdorin intonacionin etj.
- Veprimtari "Formim fjalësh me shkronja lëvizore".Përdorimi, leximi dhe shfletimi i librave të bibliotekës së kopshtit.

**Standardi 5. Fëmija shfaq interes për të lexuarit.**

**Treguesit për standardin 5**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Kërkon që t'i lexohet herëpashere një histori që i pëlqen.<br>➦ Mban mend fjalë nga libri që i pëlqen.<br>➦ Shfaq interes për librat, revistat, vizatimet dhe i shfleton (shikon) ato pa ndihmën e dikujt. | ➦ Përshkruan shkurt përmbajtjen e përrallës që pëlqen.<br>➦ Thotë dhe lexon saktësisht titullin e librit të preferuar.<br>➦ Identifikon lloje të ndryshme materialesh të printuara (të shtypura) si revistë, libër, gazetë, album etj. | ➦ Lexon fjalë që i ka mësuar në kopsht.<br>➦ Lexon vetë librin e preferuar, nëpërmjet figurave.<br>➦ Bisedon me fëmijët e tjerë për përmbajtjen e librave të ndryshëm dhe ndan librat me ta.<br>➦ Shfaq dëshirë të lexojë libra me tema |

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Kënaqet me lloje të ndryshme librash për fëmijë.<br>➦ Reagon emocionalisht ndaj figurave të ndryshme të librit.<br>➦ Bën sikur ua lexon vetë librin shokëve ose kukullave të veta.<br>➦ Shfaq interes për leximin dhe bën sikur lexon librin e preferuar duke ndjekur figurat. | ➦ Tregon për historitë që i pëlqejnë ose për veprime të caktuara të personazheve.<br>➦ Pëlqen lloje të ndryshme librash.<br>➦ Dallon cila është faqja e parë dhe e fundit në një libër.<br>➦ Lexon librin duke kaluar nga e majta në të djathtë.<br>➦ Tregon përmbajtjen e një libri që i është lexuar shpesh, me ndihmën e një të rrituri.<br>➦ Bën komente rreth librave, duke dhënë arsye pse i pëlqen ose jo.<br>➦ Identifikon tingujt fillestarë dhe ato përfundimtarë të fjalëve.<br>➦ Bën dallimin midis fjalëve që tingëllojnë ngjashëm.<br>➦ Identifikon një tingull me një shkronjë të caktuar. | interesante për të.<br>➦ Tregon se di t'i përdorë siç duhet librat.<br>➦ Dallon në një libër titullin, autorin, tekstin dhe ilustrimet.<br>➦ Përdor vizatimet/ figurat si burim informacioni (p.sh: parashikon motin, duke parë simbolet e dhëna).<br>➦ Është i interesuar të mësojë të lexojë dhe bën përpjekje "të lexojë" librin që i pëlqen.<br>➦ Lexon duke lëvizur buzët.<br>➦ Njeh fjalët nga fjalia.<br>➦ Mund të krijojë fjalë rimuese me një fjalë të dhënë. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 5**

- Krijimi i bibliotekës së grupit, pasurimi i bibliotekës së grupit.
- Lexim, rilexim i herëpashershëm i librave të thjeshtë me ilustrime me shumë ngjyra.
- Shfletim i librit duke e mbajtur në pozicionin e duhur.
- Lojë simbolike "Përralla para gjumit"(fëmija bën sikur i lexon kukullës përrallën që ajo të flejë).

- Vënia në dispozicion e shumë librave të njohur me ilustrime dhe me tituj të shkruar me shkronja kapitale si dhe lloje të ndryshme materialesh të shkruara si: gazeta, revista etj.
- Krijim posteri me figura të kopertinave të librave të njohur dhe të preferuar për fëmijët.
- Dramatizim i pjesëve teatrale
- Zhvillim i aktiviteteve të tilla si: teatër në tryezë, teatër me kukulla etj.
- Pasurimi i këndit të librit
- U ofrohen fëmijëve libra me përralla të ndryshme
- Shkëmbim dhuratash me njëri-tjetrin (libra)
- Përgatitja e një libri (ngjyrosje ,prerje, ngjitje e figurave, ,titulli i librit, emri i autorit etj).
- Lojë "Kubi rrotullues"(Në faqet e kubit shkruhen fjalë të ndryshme në përshtatje me temën. Hidhet kubi dhe fëmijët lexojnë fjalën që bie në faqen e kubit). Loja mund të zhvillohet me vezë kinder, me kuti shkrepese etj.

**Standardi 6. Fëmija kupton qëllimin e shkrimit.**

**Treguesit për standardin 6**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Përdor shkarravina për të shkruar lista, shkronja dhe histori.<br>➦ Njeh grafikën e shkronjës së parë të emrit (shkronjën kapitale)<br>➦ Njeh disa prej shenjave mjedisore (P.sh. Shenja "STOP").<br>➦ Kupton që fjalët e kanë një kuptim/qëllim.<br>➦ Shkruan dhe bën shenja në letër në mënyrë të qëllimshme.<br>➦ Emërton shkarravinën e vet, duke u treguar të tjerëve kuptimin e asaj që ka shkruar (P.sh: Një vijë e valëzuar ka kuptimin e fjalës "Mami").<br>➦ Përdor mjete të shumta të të shkruarit (lapsa, shkumësa, stilolapsa, kompjuter etj.) | ➦ Bën sikur shkruan shënime, duke përdorur shkronja të sajuara.<br>➦ Vizaton njerëz dhe objekte për të shprehur idenë e vet.<br>➦ Kopjon dy-tre shenja ose simbole të mjedisit (p.sh: një reklamë, një shenjë qarkullimi).<br>➦ Flet për vizatimin që ka bërë.<br>➦ Dallon simbolet dhe shenjat, që janë në përdorimin e përditshëm, si p.sh:, *"Hapur", "Mbyllur", "Hyrje", "Dalje" etj.*<br>➦ Kopjon fjalë të shkurtra.<br>➦ Njeh shenjat e ndryshme të printuara, p.sh:, shenjën për qëndrimin e një autobusi, taksie etj.<br>➦ Identifikon forma të ndryshme të shkrimit (me shkronja të mëdha, të vogla, kapitale, numrat etj.) | ➦ Imiton veprimtari të zakonshme shkrimi gjatë lojës.<br>➦ Shkruan *urime*, *falenderime* të shkurtra.<br>➦ Shkruan fjali të thjeshta që shprehin një mendim pesonal, duke i shqiptuar me zë të lartë fjalët.<br>➦ Shpreh me vizatim dhe me fjali të shkurtër një ngjarje/ histori.<br>➦ Pretendon se ka shkruar një letër për babagjyshin, mamin, mësuesen etj. |

| | | |
|---|---|---|
| | ➦ Kupton se të shkruarit shpreh një mendim të menduar apo të shprehur me fjalë. | |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 6**

- Fëmijëve u vihen në dispozicion materiale të larmishme për të shkruar si laps, shkumës, fletë, tabela magnetike dhe të tjera.
- Bashkim i pikave apo vijave. Fëmija ndjek një vijë pa e shkëputur dorën.
- Përgatitje e shkronjave me plastelinë, kunja shkrepëseje, rërë të lagur etj.
- Krijim të posterave duke përdorur simbole (shenjat e qarkullimit rrugor, taksive, autobuzit etj.
- Lojëra me role ”Në teatër”, “Në rrugë”, “Në dyqan” etj.)
- Përgatije kartolinash në raste festash, mesazhesh, urimesh dhe falenderimesh.
- Punë me shabllone , me stampime shkronjash (me plastelinë, me rërë)

**Standardi 7. Fëmija shfaq aftësi në rritje për të kuptuar vlerën e simbolit të fjalës e shkronjës, e më vonë vetë simbolin.**

**Treguesit për standardin 7**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bashkon pikat për të formuar shkronjat kapitale.<br>➦ Përdor simbole ose vizatime për të përfaqësuar gjuhën e folur.<br>➦ Përdor shkrimin dhe vizatimin për “të shkruar” lista, shkronja dhe | ➦ Shfaq interes për të kopjuar shkronjat e emrit të tij.<br>➦ Kupton se një fjalë e thënë përfaqësohet nga diçka e shtypur.<br>➦ Kopjon disa prej shenjave të mjedisit ose simbole. | ➦ Dallon se disa shkronja janë të mëdha e disa të vogla.<br>➦ Njeh dhe shkruan shkronjat e shtypit.<br>➦ Shkruan emrin e dikujt ose fjalë që lidhen me tematika të caktuara.<br>➦ Lexon, shkruan ose kopjon fjalë të |

| | | |
|---|---|---|
| histori.<br>➦ Identifikon emrin e vet të shkruar në etiketë me shkronja të mëdha të shtypit. | ➦ Kërkon prej të rriturve të shkruajnë komentin që i bën një vizatimi, apo atë për të cilën po flet. | përdorura shpesh në jetën e përditshme.<br>➦ Imiton veprimtari të zakonshme shkrimi gjatë realizimit të lojërave.<br>➦ Përshkruan vizatimet e veta me tekste të shkurtra.<br>➦ Dallon shkronjat nga numrat.<br>➦ Radhit fjalët e një fjalie me 2-5 fjalë duke parë modelin. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 7**

- Pasurimi i këndit të shkrimit me mjete të shumta për të shkruar: lapustila, shkumësa, bojëra dhjami, bojëra uji etj.
- Renditja e shkronjave të emrit sipas modelit të dhënë.
- Shkrimi i shkronjave ose vizatim i figurave me bashkim pikash.
- Shkrimi i fjalëve duke i kopjuar sipas modelit.
- Veçim i shkronjave të mëdha nga ato të voglat.
- Veçimi i shkronjave nga numrat.
- Përshkrim tabloje duke identifikuar disa shenja (stop, simbolet e kalendarit të motit) etj.
- Përgatitje e shkronjave lëvizore (me materiale të ndryshme)
- Ndërtim fjalish me etiketa.
- Lidhja e figurës me etiketën përkatëse.
- Lojë didaktike “Gjej në tablo vendin e shenjës”(identifikimin e shenjave të njëjta).

# FUSHA: PËRQASJET NDAJ TË NXËNIT

## Përshkrimi i fushës

Periudha e fëmijërisë së hershme është koha kur të gjithë fëmijët mësojnë se si të mësojnë. Secila fushë zhvillimi reflekton përmbajtjen e njohurive dhe të aspekteve të veçanta të dukurive që ndodhin me zhvillimin moshor të fëmijëve dhe ka të bëjë me mënyrën se si këto njohuri apo aftësi janë fituar. Përqasja e fëmijës ndaj të nxënit varet nga karakteristikat e tij/e saj (temperamenti dhe gjinia), gatishmëria, motivimi, nga pritshmëritë e familjes, komunitetit në të cilin fëmija bën pjesë, mjedisi familjar e shoqëror dhe nga vlerat kulturore.

Pavarësisht asaj se çfarë mëson, fëmija duhet t'i përdorë aftësitë e qasjes ndaj të mësuarit si strategji pozitive për të drejtuar të nxënit e vet. Kurioziteti dhe interesi për mjedisin që e rrethon dhe për çdo gjë të re që ndodh në të, janë komponentët e parë të qasjes ndaj të nxënit. Marrja e iniciativës dhe stimulimi nga të rriturit për ta zhvilluar atë përbëjnë komponentin e dytë të qasjes ndaj të nxënit, nëpërmjet të cilës fëmija zhvillon gadishmërinë për të mësuar, por edhe mënyrën se si e drejton veten në këtë proces. Këmbëngulja tregon se si fëmija merret vazhdimisht me të njëjtën veprimtari apo aktivitet, madje edhe pas përballjes me pengesa apo vështirësi të ndryshme. Kreativiteti dhe imagjinata, si aftësi e fëmijës për të përshtatur materiale, veprimtari apo aktivitete në situata të reja apo me të tjera qëllime, shihet si komponent i rëndësishëm i përqasjes ndaj të nxëit.

Nëpërmjet vëzhgimit të qëllimshëm dhe mbështetjes së vazhdueshme fëmija ndihet i suksesshëm në njohjen dhe zbulimin e vetes në mënyrë të sigurtë. Vetëm duke e mbështetur në aktivitetet që kryen, fëmijës i rritet kurioziteti rreth botës që e rrethon. Mënyra më mirë për të ndihmuar fëmijën të mësojë është loja. Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri dhe janë të ndryshëm në mënyrën si nxënë dhe në sitlin që përdorin për të mësuar.

### Nënfushat dhe përshkrimi i tyre

## 5.1 Kurioziteti dhe interesi

## 5.2 Iniciativa

## 5.3 Këmbëngulja dhe vëmendja

## 5.4 Krijimtaria dhe imagjinata

## 5.5 Reflektimi dhe interpretimi

**Kurioziteti dhe interesi.** Kurioziteti përcaktohet si nevojë, etje, dëshirë për njohuri, është thelbi i motivimit, për çdo veprim që kryen çdo individ. Fëmija parshkollor është kureshtar i vërtetë. Ai e ka të nevojshme të shohë, të prekë, të shijojë apo të nuhasë. Shumë rrallë fjalët e të rriturve e shuajnë kureshtjen e madhe të fëmijës së kësaj moshe. Kështu në pjesën më të madhe të rasteve, fëmija vazhdon t'i provojë gjërat vetë të manipulojë, të eksplorojë, për t'i shkuar zbulimit deri në fund. Kjo "uri" e fëmijës për të gjetur dhe kjo gatishmëri për të zbuluar gjithçka, të bën të vlerësosh se fëmija ka nevojë për liri veprimi, për mjedise të hapura, për pavarësi dhe drejtim nga i rrituri, në mënyrë që të zbulojë me të gjitha shqisat dhe aftësitë për atë çfarë i intereson.

**Iniciativa**. Iniciatiava i referohet aftësisë në rritje të fëmijës për të shfaqur shpirtin e pavarësisë dhe sensin e kontrollit mbi zgjedhjet që bën. Parashkollorët mësojnë nëpërmjet lojës. Loja është "puna" e tyre. Fëmija, të cilit i është dhënë më tepër liri në zhvillimin dhe përdorimin e imagjinatës, më tepër mundësi për të luajtur, e ka më të zhvilluar sensin e iniciativës dhe të realizimit të veprimtarive të ndryshme të cilat i interesojnë. Nëse të rriturit e pengojnë lojën imagjinare të fëmijës, mund të zhvillojnë padashje tek ai ndjenjën e fajit dhe mund të bëhen shkas që fëmija të ndërpresë ndërmarrjen e iniciativave të reja.

**Këmbëngulja dhe vëmendja**. Këmbëngulja i referohet kapacitetit të fëmijës për t'u angazhuar plotësisht në atë që është duke bërë dhe me mënyrën si përballet me sfidat. Këmbëngulja i referohet jo vetëm mënyrës se çfarë mëson fëmija, por edhe se si mëson. Studime të ndryshme tregojnë se nëse fëmija ka vendosmëri dhe këmbëngul në mbarimin e një veprimtarie që në moshë të hershme, atëherë ai ka shanse të jetë më i suksesshëm në jetë. Fëmija fiton vendosmëri në studimin, eksporimin, përqendrimin në një veprimtari, nëse i jepet kohë e mjaftueshme nga i rrituri për ta kryer deri në fund kërkimin që ka nisur dhe nëse gjendet i rrethuar me lodra, materiale e mjete që i stimulojnë këto cilësi.

**Krijimtaria dhe imagjinata**. Krijimtaria i referohet kapacitetit të fëmijës për të shprehur veten si person unik, nëpërmjet mënyrës si e sheh botën dhe si e shpreh talentin që ka.

**Reflektimi dhe interpretimi**. Aftësia për të reflektuar eshtë baza që më pas fëmija të bëjë zgjedhjet e veta, të rregullojë sjelljen, të përballet me sfida dhe të marrë përgjegjësi. Aftësia për zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë e larta të të menduarit zhvillohen kur fëmija nxitet të reflektojë pas asaj që bën, të bëjë parashikime, të bëjë pyetje dhe të ngrejë hipoteza, të cilat, me ndihmën e të rriturit përpiqet t'i vërtetojë. Fëmija 3-6 vjeç është në gjendje të bëjë reflektime për sjelljen që shfaq dhe për mjedisin që e rrethon. Ai, gjithashtu, reflekton për mënyrën se si ndihet dhe mundohet ta shfaqë dhe të japë arsye se pse ndihet ashtu.

## 5.6 STANDARDET SIPAS NËNFUSHAVE DHE TREGUESIT E TYRE

| | |
|---|---|
| **V.1 Kurioziteti** | **Standardi 1.** Fëmija shfaq kuriozitet të mësojë diçka të re.<br><br>**Standardi 2.** Fëmija shfaq interes për të përjetuar përvoja të reja. |
| **V.2 Iniciativa** | **Standardi 3.** Fëmija shfaq iniciativë pa dhe në ndërveprim me të tjerët. |
| **V.3 Këmbëngulja dhe vëmendja** | **Standardi 4.** Fëmija tregon këmbëngulje për të marrë pjesë në aktivitete, veprimtari edhe kur gjatë zhvillimit të tyre përballet me vështirësi. |

| | |
|---|---|
| **V.4 Kreativiteti dhe imagjinata** | **Standardi 5.** Fëmija përdor aftësitë krijuese dhe imagjinatën në aktivitetet e jetës së përditshme. |
| **V.5 Reflektimi dhe interpretimi** | **Standardi 6.** Fëmija mëson nga përvojat individuale dhe i përdor njohuritë e fituara në situata të reja. |

## 5.7 TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE

**Standardi 1. Fëmija shfaq kuriozitet të mësojë diçka të re.**

**Treguesit për Standardin 1**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Eksploron menjëherë mjedisin në të cilin ndodhet, për të gjetur se çfarë ka aty.<br>➦ Nuk heziton të pyesë të tjerët për të marrë informacionet që i interesojnë (p.sh: pyet *"Si e ke emrin?", "Ku e ke vrarë dorën?"* etj.).<br>➦ Përdor shpesh pyetjet *"Kur?", "Ku?", "Çfarë?"* për të marrë të dhëna që i interesojnë.<br>➦ Shfaq habi përse diçka është ashtu siç është. | ➦ Përdor më tepër pyetjen "Pse?" për të marrë informacion dhe njëkohësisht opinionin e të tjerëve për një çështje të caktuar.<br>➦ Shfaq interes për të zbuluar veten në aspektin fizik; Bën pyetjen "Pse?", për detaje të ndryshme të trupit të vet dhe pse këto të fundit janë të ndryshme nga fëmijët e tjerë (*P.sh: Pse i kam sytë blu?)* | ➦ Bën pyetje për ndryshimet që ndodhin rreth tij.<br>➦ Përfshihet në diskutime për ngjarjet e reja që kanë ndodhur (p.sh, *Si ndodhi? Pse ndodhi?* etj.).<br>➦ Shfaq kënaqësi gjatë diskutimit për një informacion të ri dhe shpreh gatishmëri për të treguar çfarë di në lidhje me të. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 1**

- Ofron një mjedis të pasur me mjete dhe materiale të ndryshme të përshtatshme për moshën për të eksploruar, manipuluar, vëzhguar dhe që nxit imagjinatën, kreativitetin në këndin e artit dhe të shkencës.
- Vëzhgime në natyrë (lupa për zmadhim të luleve, barit, milingonave, çelja e bimëve, luleve etj.)
- U vihen në dispozicion libra me përmbajtje shkencore dhe enciklopedi, pamje filmike të marra nga mjedisi jashtë gjatë ekskursioneve apo vëzhgimeve të bëra më parë.
- U vihen në dispozicion mjete, materiale, objekte dhe sende frymëzuese që t'i nxisin imagjinatën si dhe albume dhe foto të cilat i njohin fëmijët.
- Diskutime rreth përvojave personale.
- Krijimi i një mjedisi stimulues duke ndryshuar vazhdimisht mjedisin (orenditë).
- Lojë: "Nata, dita"
- Krijimi i ylberit. Sipërfaqja e një disku vendoset në një pozicion ku i bie rrezja e diellit dhe reflektimi i saj formon YLBERIN.

**Standardi 2. Fëmija shfaq interes për të përjetuar përvoja të reja.**

**Treguesit për Standardin 2**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| ➦ Shfaq interes për njerëzit që e rrethojnë.<br>➦ Shfaq interes për veprimtaritë dhe punët me të cilat merren njerëzit që e rrethojnë.<br>➦ Gradualisht identifikon fushën e vet të interesit (*p.sh: për makinat, kafshët, kukullat, lodrat, veshjet, profesionet etj.*). | ➦ Kërkon dhe eksperimenton duke përdorur materiale të reja (p.sh: kombinon ngjyrat, përzien lëndë të ndryshme etj.)<br>➦ Shfaq interes dhe përpiqet të mësojë rreth aktiviteteve që kryejnë të rriturit duke u qëndruar pranë ose duke u bërë pyetje teknike (p.sh: *Çfarë hodhe në tas? Çfarë do të bësh tani?* etj.). | ➦ Kërkon informacione të reja, sipas interesit të tij personal, duke kërkuar ndihmën e të rriturve.<br>➦ Pyet për të mësuar kuptimin e fjalëve të reja.<br>➦ Shfaq entuziazëm për kryerjen e udhëtimeve me familjen apo eksplorimin e vendeve të reja. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 2**

- U ofrohen fëmijëve libra, foto, figura, materiale, mjete, sende apo objekte që kanë të bëjnë me profesione të ndryshme.
- Lojëra me kuba dhe konstruksione në qendrën manipulatore.
- Gara me biçikleta me tre rrota dhe me makina.
- Vënia në dispozicion e materialeve të ndryshme për të eksperimentuar.
- Pasurimi i këndeve me materiale sipas veprimtarive që zhvillohen.
- Përgatitja e sallatës me perime të ndryshme.
- Kolazhe festash me kombinim bojërash në mur ose kartona ( pikturimi me gishta, duar, penela në mur, kartona, beze, kompesatë etj ).
- Lexim të librave që stimulojnë interesin e fëmijëve për njerëzit, vendet, botën natyrore, prejardhjen e emrave lidhur me historinë duke marrë shkas nga emrat e fëmijëve si p.sh. emrat Teuta, Genti, Bardhyl, Skënder etj.
- Organizimi i vizitave, ekskursioneve, piknikëve për të zbuluar vende të reja (botën natyrore, mal, pyll, det etj.)

**Standardi 3. Fëmija shfaq inisiativë pa dhe në ndërveprim me të tjerët**

**Treguesit për standardin 3**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bashkohet në një aktivitet i cili është në proces dhe nuk ka përfunduar ende.<br>➦ I kërkon një fëmije tjetër të luajnë së bashku.<br>➦ Zgjedh aktivitete të reja edhe pse është i angazhuar në lojë. | ➦ Merr iniciativë që të marrë pjesë në mënyrë vullnetare në aktivitete ndihme, pa u urdhëruar nga i rrituri (p.sh: heq rërën nga dyshemeja, mbledh pjatat pas mbarimit të drekës etj.).<br>➦ Merr vendime në mënyrë të pavarur (zgjedh materiale, u ofron ndihmë të tjerëve, kryen veprime korrekte edhe kur të tjerët nuk i bëjnë).<br>➦ Inicion aktivitete bazuar tek sugjerimi i të rriturit.<br>➦ Shpreh dëshirën të kryejë aktivitete që i shërbejnë vetë atij, të "ndërtojë" objekte, lodra apo të gjejë informacion për objekte interesante.<br>➦ Propozon tipin e lojës që do të zhvillojë, kur ndahen në qendra aktiviteti. | ➦ Zgjedh vetë një aktivitet që i përshtatet interesit të tij.<br>➦ Shpik projekte apo struktura pune dhe i zbaton pa ndihmën e të rriturit.<br>➦ Planifikon një aktivitet dhe e zbaton atë.<br>➦ Inicion lojëra dhe aktivitete me persona të tjerë (fëmijë dhe të rritur). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 3**

- Ofrohen mjete, lodra, lojëra për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve sipas temave të caktuara ku nxitet iniciativa dhe ndërveprimi i fëmijëve me të rriturit dhe bashkëmoshatarët.
- Bashkim i formueseve (pazlla).
- Sistemim i lodrave dhe librave.

- Ndërtimi i një qyteti, pallati me kuti të mëdha dhe të vogla nga një grup me më shumë se 2 fëmijë
- Aktivizimi në lojra në grupe të mëdha dhe të vogla fëmijësh (dominoja, formueset etj.).
- Lojëra me role: “Unë jam mësuesja”, “Kamarieri”, “Në dyqan”.
- Vënia e fëmijëve të luajnë njërën prej tre lojërave të dhëna nga mësuesja.
- Fëmija lihet i lirë të eksperimentojë dhe eksplorojë në një mjedis të pasur dhe kreativ.

**Standardi 4. Fëmija tregon këmbëngulje për të marrë pjesë në aktivitete, veprimtari edhe kur gjatë zhvillimit të tyre përballet me vështirësi.**

**Treguesit për standardin 4**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Bashkon tre ose më tepër pjesë të një lodre.<br>➦ Përpiqet të zgjidhë një detyrë edhe kur ajo është e vështirë, duke e filluar dhe duke u rikthyer sërish.<br>➦ Dëgjon një përrallë nga fillimi në fund.<br>➦ Kërkon ndihmë kur has në vështirësi gjatë një aktiviteti që po kryen, për ta çuar atë deri në fund.<br>➦ Vazhdon të jetë i përfshirë në një aktivitet të caktuar edhe pse mund të ketë faktorë shqetësues rrotull tij/saj. | ➦ Qëndron i përfshirë në një aktivitet të cilin e ka zgjedhur vetë për 5-10 minuta.<br>➦ Vazhdon përpjekjet për të plotësuar qëllimet edhe pse mund të dështojë në përpjekjen e parë (p.sh:, në mësimin e biçikletës, kur vesh një kukull etj.).<br>➦ Përdor më tepër se një strategji për të zgjidhur një problem. | ➦ Ndjek me vëmendje të rriturin ndërsa i tregon një histori. (Nëse i pëlqen dëgjon edhe ritregimin).<br>➦ E rikthen menjëherë vëmendjen në një aktivitet që ka filluar edhe pasi shkëputet për disa momente prej tij.<br>➦ Qëndron veçanërisht i përqëndruar në punë e veprimtari që i pëlqejnë. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 4**

- Shfletim të librave me përralla, libra me histori, libra me ilustrime, libra me muzikë, libra me prekje etj.
- Vënia të kryejnë aktivitete fizike si : kapërcim pengesash, hapat e para të mësimit të bicikletës, hedhja nga një lartësi.
- Vënia të kryejnë aktivitete fizike si : kapërcim pengesash, hapat e para të mësimit të biçikletës, hedhja nga një lartësi.
- U ofrohen fëmijëve libra, albume, revista, veshje dhe materiale të ndryshme për të përfunduar një projekt.
- Stimulohen dhe u lihet kohë e mjaftueshme për të zhvilluar aktivitetin.
- Lexime të materialeve me intonacion, me ndalesa (pauza) të vogla dhe imitime të zërave të personazheve.

**Standardi 5. Fëmija përdor aftësitë krijuese dhe imagjinatën në aktivitetet e jetës së përditshme.**

**Treguesit për Standardin 5**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Sajon, krijon lojëra të reja, këngë dhe aktivitete të ndyshme të cilat e bëjnë të ndihet mirë.<br>➦ Gjen mënyra të reja të të bërit të gjërave (p.sh: vendos një strukturë blloku në mënyrë të veçantë, jo si më parë). | ➦ Luan çdo ditë lojëra dhe zhvillon aktivitete në mënyra të ndryshme duke ndërthurur lodrat.<br>➦ Shpreh ide nëpërmjet aktiviteteve artistike, lëvizjeve ose muzikës.<br>➦ Merr pjesë në lojën simbolike (përdor bananen si telefon etj.).<br>➦ Shpik aktivitete apo lojëra të reja.<br>➦ Përdor imagjinatën për të dhënë ide.<br>➦ Shpreh idetë përmes artit, ndërtimit, | ➦ Ndryshon rrjedhën e historive të njohura, duke futur karaktere të sajuara prej tij.<br>➦ I kombinon aktivitetet dhe materialet në mënyra të ndryshme.<br>➦ Përdor mjete të ndryshme komunikimi, për të shprehur në mënyrë krijuese mendime, ide, ndjenja etj.<br>➦ Është fleksibël në përmbushjen e një detyre, duke qenë i hapur ndaj ideve të reja (p.sh: nuk mjaftohet me një |

| | | |
|---|---|---|
| | lëvizjes apo muzikës.<br>➦ Përdor mjetet që përdoren për një qëllim specifik, për të luajtur lojën simbolike apo për të realizuar dramatizimin (p.sh: kuvertën e bën çadër për piknik). | zgjidhje për një çështje, por eksperimenton edhe ide dhe mënyra të reja, derisa ta pëlqejë atë). |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 5**

- U vë në dispozicion materiale të larmishme, objekte që t'a ndihmojnë për të luajtur lojën e pretenduar.
- Lojëra me role si "Kuzhiniere si gjyshja", "Luaj si gjyshi domino".
- Vihen të luajnë lojëra simbolike dhe lojëra muzikore.
- Inkurajohen fëmijët për të krijuar këngën dhe histori apo për të ndryshuar fjalë nga histori të njohura.
- Vihen në dispozicion figura me të cilat krijon një histori të re.
- Leximi në çdo kohë i librave të ndryshëm.

**Standardi 6. Fëmija mëson nga përvojat individuale dhe i përdor njohuritë e fituara në situata të reja.**

**Treguesit për standardin 6**

| Mosha 3-4 vjeç | Mosha 4-5 vjeç | Mosha 5-6 vjeç |
|---|---|---|
| ➦ Lidh përvojën e fundit me një përvojë të ndodhur kohë më parë (*p.sh:, lan duart para çdo vakti*)<br><br>➦ Mendon me zë dhe flet në një situatë të caktuar. | ➦ U tregon të tjerëve për ngjarje interesante që i kanë ndodhur në të shkuarën e afërt (para pak orësh, një-dy ditë më parë etj.).<br><br>➦ Përdor njohuritë e mëparshme për të kuptuar përvojat e reja (p.sh, pasi ka mësuar diçka për gjarpërinjtë, fëmija bën krahasime kur sheh një krimb në tokë). | ➦ Bën lidhjen mes ideve, koncepteve dhe subjekteve (p.sh: imazhe që i ka parë gjatë shëtitjes në park i përdor në aktivitetet që bën në klasë).<br><br>➦ Tregon nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve se e kupton se çfarë ndjejnë të tjerët.<br><br>➦ Përdor shumëllojshmëri metodash për të shprehur mendimet dhe ndjenjat. |

**Strategjitë dhe veprimtaritë për përmbushjen e treguesve të standardit 10**

Ofrohen materiale të ndryshme të cilat i përdor në situata të caktuara të përjetuara më parë nga vetë fëmija dhe të risjella në mënyrë të përafërt duke i përdorur në : lojëra didaktike “ gjeje ku e ka vendin “, lojëra simbolike ; lojë me role; biseda të ndryshme të cilat ndihmojnë në shprehjen e mendimeve dhe ideve duke përdorur njohuritë në situata të reja.